

27.05.2021
Ora 15:48

RENDI I DITËS

Projektvendim "Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 44, datë 09.05.2021 të subjektit ankues koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim PD-AN, për zonën zgjedhore Qarku Fier".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PD, PS, LSI

Z. I. Rusmali: Hapim seancën për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr.44, të subjektit ankimues PD-AN, përfaqësuar nga zoti Marash Logu në këtë seancë. Objekti i ankimit është kundërshtimi i vendimit nr.348, datë 04.05.2021, "Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin në zonën zgjedhore Qarku Fier për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill." Subjekti kërkon shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve të zhvilluara në këtë datë për zonën zgjedhore Qarku Fier dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore të Qarkut Fier. Përfaqësuesi i subjektit është prezent, zoti sekretar i përgjithshëm që gjithashtu është prezent mund të na informojë për kërkesat për t'u futur në këtë proces si palë e interesuar.

**Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Z. Y. Merkaç: Partia Socialiste ka paraqitur kërkesë për t'u futur si palë e interesuar në procedurën amnitive kundër vendimit nr.348, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve përfaqësuar nga përfaqësuesit ligjor Eridian Salianji dhe Maringlen Legisi.

Z. I. Rusmali: Mirë përfaqësesi i palës së interesuar është prezent.

Z. M. Legisi, përfaqësues i PS-së: Prezent.

Z. I. Rusmali: Kështu që mund të procedojmë me shqyrtimin, kërkesa paraprake nga përfaqësuesit e palëve ose nga anëtarët ka? Nuk ka kërkesa paraprake, nuk ka deklarime për konflikt interesi. Në qoftë se do të futesh proceduralisht duhet të bësh kërkesë.. Të lutem merr mikrofonin dhe na deklaro vullnetin në emër të subjektit.

Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së: Po pranoj që të jem si palë e interesuar në këtë çështje, faleminderit.

Z. I. Rusmali: Dhe keni autorizimin e subjektit për këtë gjë apo jo. Do të thotë që subjekti zgjedhor është i përfaqësuar ligjërisht si palë e interesuar në këtë seancë. Ia japim fjalën përfaqësuesit të Partisë Demokratike të parashtrojë pretendimin e tij përpara kësaj trupe.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti kryesues i seancës, PD-AN e përfaqësuar nga Sekretari për Çështjet Zgjedhore zoti Ivi Kaso dhe juristi Marash Logu. Në datën 9 Maj 2021 ka depozituar një kërkesë ankimore me objekt kundërshtimi i vendimit nr.348, datë 04.05.2021, "Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin në zonën zgjedhore Qarku Fier për

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.” Objekti i dytë është pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25 Prill 2021, në zonën zgjedhore Qarku Fier. Objekti i tretë është urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Fier në periudhën më të afërt zgjedhore. Baza ligjore e kërkesës sonë janë nenet 1, 18, 35, 45 dhe 64 të Kushtetutës së Shqipërisë. Janë nenet 8 dhe neni 3 protokollit 1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, janë pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në çështjet zgjedhore të Komisionit të Venecias. Nenet 12 pika 4, neni 21, pika 1, neni 33 germa “a”, neni 91, 92, 98 pika 4, neni 106 pika 1, neni 113, neni 123, neni 123/1, neni 124, neni 143, neni 160 dhe neni 161 të Kodit Zgjedhor. Si dhe nenet 6 dhe 7 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe nenet 3 dhe 6 të vendimit nr.9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve në datën 4 Maj 2021, PD-AN ka marrë dijeni për vendimin nr.348, datë 04.05.2021, “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin në zonën zgjedhore Qarkut Fier, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.” Duke mos qenë aspak dakord me këtë vendim për shkak se vlerësojmë se gjatë procesit zgjedhro prej të cilit ka dalë ky vendim ka ndodhur shkelje të rënda të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor si dhe tërësia e shkeljeve të ligjit të ndodhura në këtë zonë zgjedhore ka cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë që ka ndikuar në ndarjen e mandateve siç do të provohen gjatë këtij shqyrtimi administrativ. Po parashtrojmë këtë ankim me faktet, dispozitat

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

ligjore dhe arsyetimin ligjor si vijon: Në datën 25 Prill 2021 janë zhvilluar zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në zonën zgjedhore Qarku Fier ku kanë marrë pjesë në zgjedhje 182 mijë e 906 votues ose 47.94%. Në datën 26 dhe 27 prill është kryer numërimi i votave për subjektet zgjedhore gjatë të cilët janë konstatuar 173 mijë e 525 fletë votimi të vlefshme dhe 9 mijë e 375 fletë votimi të pavlefshme ose 5.13%. Mandatet në këtë zonë zgjedhore pra në Qarkun Fier janë ndarë si vijon Partia Socialiste 9 mandate, Partia Demokratike 6 mandate dhe Lëvizja Socialiste për Integrim 1 mandat. Diferenca ndërmjet votave të subjektit zgjedhor Partia Socialiste për mandatin e fundit me subjektin zgjedhor Partia Demokratike ishte 6 mijë e 545 vota ose 2 mijë e 380 më pak vota se numri i votave të pavlefshme. Në datën 4 Maj 2021 me vendimin 349 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Fier për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputet në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021. Duke qenë se jemi të bindur bazuar në prova dhe fakte të pakundërshtueshme se periudha para dhe zgjedhore u shoqërua me shkelje të rënda të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikoi drejtpërdrejt në ndarjen e mandateve në vijim do të paraqesim faktet që mbështesin këto pretendime. Shtylla e parë ka të bëjë pikërisht me blerjen e votës nëpërmjet përdorimit të personave me precedent të tmerrshëm kriminal për të cilin kemi depozituar 17 prova. Nga provat e mbledhura nga Partia Demokratike para dhe gjatë fushatës zgjedhore rezultoi se persona me rekorde të tmerrshme kriminale janë përfshirë në fushatën e Partisë Socialiste si eksponent që kontribuonin në këtë fushatë edhe për shkak të përfitimeve që ata kanë marrë nga Partia Socialiste. Në këtë kërkesë

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

ankimore ne kemi relatuar gjërësisht fakte dhe të dhëna konkrete sa u përket këtyre personave të përfshirë në këto aktivitete kriminale. Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar 50 kallëzime penale në Prokurorinë e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe 130 kallëzime në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm. Ndër 50 kallëzimet e depozituara në SPAK 30 prej tyre kanë të bëjnë me raste flagrante të shitblerjes së votës nga drejtues, përfaqësues apo mbështetës të Partisë Socialiste. Në Qarkun e Fierit për rastet e shitblerjes së votës dhe shkeljet e tjera flagrante të ligjit që kanë cënuar procesin zgjedhor Partia Demokratike ka depozituar një numër të konsiderueshëm kallëzimesh penale për të cilat do t'i citojmë njërin pas tjetrit në vijim të kësaj kërkesë ankimore. Në datën 2 Prill 2021, Partia Demokratike e Shqipërisë ka kallëzuar në Prokurorinë e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar shtetasit Petrit Rama Drejtor i Metrologjisë dhe Kalibrimit shtetasin Fredi Kokoneshi Kryetar i Bashkisë Divjakë. Shtetasen Zhaklin Nurçe me detyrë drejtor i Inukun për Jugun, shtetasen Kristina Gobere me detyrë Këshilltare e Bashkisë Divjakë, shtetasin Haki Halili kryeplak i fsahatit Çermë në Shkurmbin, shtetasen Gjyljana Bali përgjegjëse e Qendrës Shëndetësore Çermë Sektor, shtetasen Irena Ruçi Tashi përgjegjëse e Ndhmës Sociale në Bashkinë Divjakë, shtetasen Brunilda Ndini punonjëse turizmi Bashkia Divjakë, shtetasin Eqerem Arapi punonjës i DRTRS-së Fier dega Lushnje, shtetasin Avni Snalla Nënkyetar i Bashkisë Divjakë, shtetasin Avni Sula administrator i Njësisë Tërbuf, shtetasin Eris Stambolliu Zevëndësrejtör i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, shtetasi Ahmet Biba punonjës Kadastre në Bashkinë Divjakë, shtetasin Dorjan Spaho drejtor Kadastre në Bashkinë Divjakë, shtetasin Eltinor Mahmutaj Drejtor Rajonal i Bujqësisë, shtetasi Fredi

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Preni Përgjegjës i Emergjencave në Bashkinë Divjakë, shtetasin Marjol Shaqir Sina administrator i Agron Sina SHPK dhe Këshilltar në Këshillin Bashkiak Lushnje, shtetasin Sadush Bali me detyrë SPZ në zonën e Grabianit, shtetasin Astrit Muça, shtetasin Dailan Debinja, shtetasin Maksim Feracaku, shtetasin Kastriot Molla punonjës policie në Komisarriatin Divjakë, shtetasi Seit Molla punonjës po ashtu policie në Komisarriatin e Divjakës, shtetasin Qerem Muça punonjës policie në Divjakë dhe shtetasin Altin Shehu Shefi i Komisarriatit të Policisë Divjakë. Këta shtetas janë kallëzuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë për veprat penale shpërdorimit detyrës parashikuar nga neni 248 e Kodit Penal, dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal. Detyrimi për pjesmarrje në veprimtari politike parashikuar nga neni 328 germa “a”, i Kodit Penal. Vepra penale kanosja apo dhunimi ndaj pjesmarrësve në zgjedhje parashikuar nga neni 329 i Kodit Penal dhe të gjitha këto veprime të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal parashikuar nga neni 333/a i Kodit Penal. Ky grup në tejkalim të kompetencave të tyre, por në shkelje të pastër të ligjit janë përfshirë masivisht dhe aktivisht në fushatën e Partisë Socialiste për Qarkun e Fierit si dhe kanë ndërtuar një sistem kapilar prej intimidimin në Administratën Shtetërore dhe shitblerjen e votave. Në datën 2 Prill 2021 është kallëzuar penalisht në SPAK Rajmonda Balili Kryetare e Bashkisë Patos, Nimet Musai kandidat për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, Antoneta Dhima kandidate për deputete në Kuvendin e Shqipërisë, Omer Mamo ish deputet në Kuvendin e Shqipërisë, Gjamil Baliaj banues në Ruzhdi e Patos, Islam Shpata Kryeplak i Fshatit Kuçar, Përparim Selami banues në Zharrës Fier për veprat penale shpërdorim i detyrës parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve parashikuar nga neni 328


*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

i Kodit Penal, detyrimi për pjesmarrje në veprimtari politike parashikuar nga neni 328 “a”, i Kodit Penal. Kanosja apo dhunimi i pjesmarrësve në zgjedhje parashikuar nga neni 329, të gjitha këto veprime të kryera në formën e grupit të strukturuar kriminal siç parashikohet nga neni 333/a e Kodit Penal. Kallëzimi përkatës është depozituar pranë këtij komisioni në cilësinë e provës. Partia Demokratike po ashtu...

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ka kallëzuar pranë Prokurorisë së Rethit Gjyqësor Fier veprat penale të shit-blerjes së votës si vijon:

Në datën 17 Prill 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasve Fredi Kokoneshi, Kryetar i Bashkisë Divjakë, Valentina Prifti, arkëtare në Bashinë Divjakë, dhe Ilir Malko, punonjës i Bashkisë Divjakë. Në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe Kodin zgjedhor të ndryshuar Zyrat Arsimore në Bashki nëpërmjet Drejtorive Rajonale kanë caktuar përfaqësues/mësues pranë shkollave të mesme për të trajnuar votuesit e rinj të cilët janë nxënës në shkolla. Me qëllim ushtrimin e presionit dhe devijimin e vullnetit të zgjedhësve janë përzgjedhur mësues militantë të Partisë Socialiste, me lidhje të afërta farefisnore e miqsore të kandidatëve për deputet, psh në shkollën e mesme. Divjakë apo shkollave të tjera të cilat kishin si qëllim të ndikonin te zgjedhësit e rinj që janë edhe nxënësit e tyre. Njëkohësisht me këtë aktivitet shtetasja Valentina Prifti e punësuar si arkëtare në Bashkinë e Divjakës përgatit dhe shpërndan zarfa me para sipas familjeve dhe votuesve në këmbim të premtimit e votimit për subjektin elektorale Partia Socialiste e Shqipërisë. Shtetasi Ilir Malko në Zharrëz i punësuar së fundmi në Bashkinë Divjakë shpërndan zarfe me para në këmbim të premtimit për votuar Partinë Socialiste si dhe Leje legalizimi në këmbim të të njëjtit premtim. Kallëzimi penal përkatës është depozituar pranë këtij komisioni me cilësinë e Provës me Nr. 8. Në datën 24 Mars 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Nevruz Shehu, banues i fshatit Sulzotaj në Bashkinë Divjakë. Shtetasi Nevruz Shehu banues në fshatin Sulzotaj në Bashkinë Divjakë zhvillon aktivitet në kundërshtim me ligjin në zonën e Njësisë administrative Tërbuf, Cermë, Divjakë duke u kërkuar votimin e tyre për kandidatin Myslim Murrizi gjatë zgjedhjeve të datës 25 Prill të vitit 2021. Ky shtetas në këmbim të premtimit të votimit për kandidatin për deputet Myslim Murrizi

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

ofronte shuma deri në 50 EURO për një votë. Kjo provë është depozituar bashkë me ankimin e paraqitur nga ana e subjektit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim. Në datën 01 Prill 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasve Petrit Rama, Drejtor i Metrologjisë dhe Kalibrimit, Fredi Kokoneshi, Kryetar i Bashkisë Divjakë, Zhaklin Nurce, Kristina Gobere, Haki Halili, Gjyljana Bali, Irena Ruci, Brunilda Ndini, Eqerem Arapi, Avni Snalla, Eris Stambolliu, Ahmet Biba, Dorian Spaho, Eltinor Mahmutaj, Fredi Preni, Marjol Sina, Sadush Bali, Astrit Muca, Dajlan Debinja, Maksim Feracaku, Kastriot Molla, Seit Molla, Qerem Muca, Altin Shehu. Të gjithë këta shtetas me funksione publike të cilët janë cituar nga ana e Partisë Demokratike në fqen 5 dhe 6 të kërkesës së saj ankimore. Në territorin e Bashkisë Divjakë dhe Lushnjë është krijuar një grup i strukturuar kriminal i cili ka qëllim kryerjen e veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve. Në këtë grup ishin përfshirë pjesëtarë të administratës shtetërore, anëtar të subjektit elektoral Partia Socialiste dhe synojnë tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve, frikësimin e kundërshtarve politik të identifikuar prej tyre me metoda të kundraligjshme, presionin përmes përdorimit të administratës shtetërore, organeve të rendit, elementëve me precedentë të rrezikshëm kriminal apo edhe përdorimit të parave të pista të krijuara përmes metodave korruptive dhe tenderave abuzive të Bashkisë Divjakë e Lushnjë. I gjithë ky aktivitet dhe përfshirja e këtyre personave me qëllimin e vetëm blerjen e votave për llogari të subjektit elektoral Partia Socialiste. Këta shtetas, kanë zhvilluar veprimtari politike në favor të subjektit politik Partia Socialiste nën kërcënimin e vendit të punës prej drejtuesve të institucioneve përkatëse, derë me derë duke trokitur te fermerët dhe duke u kërkuar votën për Partinë Socialiste dhe në këmbim u kanë premtuar rimbursim të naftës. Po ashtu nga ana e Partisë Demokratike është denoncuar edhe shtetasi Anduel

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Mbriçi, i cili ishte angazhuar në shpërndarjen e ndihmave ushqimore në këmbim të votës që këta persona do të jepnin në favor të Partisë Socialiste. Nga ana e Partisë Demokratike janë relatuar edhe kallëzimi i paraqitur në Prokurorië e Rrethit Gjyqësor Fier të datës 1 Pril 2021, por dhe në materialin e kërkesës ankimore se si këto ushqime paktoheshin dhe magazinoheshin brenda ambjentëve të Bashkisë Divakë dhe më pas shpërndaheshin familjeve në nevojë me qëllim manipulimin dhe tjetërsimin e votës së vullnetit të tyre. Në datën 24 Mars 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Bardhyl Kapaj, Drejtor i Patentave Fier. Shtetasi Bardhyl Kapaj me detyrë Drejtor i Patentave në Fier është angazhuar në fushatë elektorale duke shpërblyer persona të ndryshëm në këmbim të marrjes së premtimit prej tyre se do të votojnë subjektin elektoral Partia Socialiste. Ky shtetas u jep personave të cilët premtojnë se do të votojnë për Partinë Socialiste Dëshmitë e Aftësisë duke shmangur taksën e korrupsionit dhe në ndonjë rast edhe paguar tarifat shtetërore për paisjen me Dëshmi Aftësie. Konkretisht me kemi denoncuar një rast se si një shtetas banues në fshatin Peshtan, të cilit nuk po ia përmend emrin për shkak të të dhënave personale është pajisur me dëshmi aftësie në këmbim të premtimit të marrë prej tij se do të votojë Partinë Socialiste. Në datën 31 Mars 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Dilaver Shyti, Administrator i Njësisë Administrative Ndërmenas, shtetasit Afrben Voja, Drejtor i Ambientit në Bashkinë Fier, shtetasit Gëzim Dhima, Drejtor i Tranagatit në Albpetrol, shtetasit Ilir Vrapi, Administrator i Njësisë Administrative Kuman, shtetasit Arian Fasko, Drejtor i OSHEE për Jugun, shtetasit Gerti Bilera, Drejtor i Shpërndarjes Fier, shtetasit Flamur Mato, Drejtor i Komanduar i Albpetrol, shtetasit Kudret Rama, Përgjegjës i Zjarrfikseve Fier, si dhe shtetasve: Petrit Kanani, Rexhep Nuhu, Astrit Elmazi, Sokol Kuka, e të tjerë. Të gjithë këta shtetas të përfshirë, në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

fakt të skeduar për veprimtari të paligjshme, veprimtari kriminale dhe të përfshirë në aktivitetin e paligjshëm të blerjes, manipulimit dhe tjetërsimit të vullnetit të zgjedhësve në Qarkun e Beratit. Konkretisht: shtetasi Dilaver Shyti me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Ndërmenas i cili më parë është proceduar në prokurori për veprat penale të falsifikimit të dokumentave zyrtare zhvillonte veprimtari në drejtim të frikësimit të shtetasve të Qarkut të Beratit, votues të Partisë Demokratike duke i vendosur gjoba, penguar për realizimin e të drejtave të tyre kur paraqiten pranë kësaj Njësie Administrative kryesisht kur kërkonin leje si p.sh. leje rikonstrukcion banese, si dhe shpërndan para në këmbim të premtimit për të votuar Partinë Socialiste. Shtetasi Gëzim Dhima drejtor i TRANAGATIT pranë kompanisë publike Albpetrol shpërndan naftë në formë shpërblimi për personat të cilët premtojnë të votojnë Partinë Socialiste si dhe pranë strukturave e Partisë Socialiste për nevojat e fushatës elektorale. Shtetasi Ilia Vrapit i njohur edhe me emrin Bardh Plepi, person i dënuar më parë për vrasje aktualisht Administrator i Njesisë Administrative Kuman përveç dyshimit për falsifikim formularësh në kuadër të ligjit për dekriminalizimin shpërndante para dhe shpërblime e ndihma në këmbim të premtimit për të votuar për subjektin elektoral Partia Socialiste. Shtetasi Astrit Elmazi pjesë e bordit drejtues të Ujësjetës Patos zhvillon veprimtari elektorale në kundërshtim me ligjin duke përdorur asetet dhe burimet njerëzore të ndërmarrjes publike Ujësjetës Patos në këmbim të premtimit për të votuar subjektin politik Partia Socialiste në zgjedhjet e 25 Prillit 2021. Shtetasi Kudret Rama me detyrë përgjegjës i zjarrfikësve Fier merr pjesë në shpërndarjen e parave në këmbim të votimit për subjektin elektoral Partia Socialiste në zonën e Cakranit. E njëjta veprimtari zhvillohet edhe nga ana e shtetasve Petrit Kanani, Rexhep Nuhu dhe Arian Fasko.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Në datën 24 Mars 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasve Mimoza Celibashi, Drejtoreshë e Kryqit të Kuq Dega Fier, Agim Celibashi, anëtar i Partisë Socialiste, Shpëtim Duraj, punonjës i Bashkisë Fier dhe Elton Vruzhi. Këta shtetas ishin përfshirë masivisht në vera të ndryshme penale, me qëllim manipulimin dhe tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve në Bashkinë Fier. Shtetasi Feti Caka banues në Levan, bashkëshortia e të cilit është punonjëse e Kryqit të Kuq Dega Fier dhe bashkë me fëmijët e tyre shpërndanin ushqime në formë ndihmash dhe një shumë prej 5000 lekësh të reja në favor të subjektit elektoral Partia Socialiste. Nga ana e Partisë Demokratike është denoncuar edhe vendi ku kryheshin këto aktivitete të paligjshme dhe konkretisht në shkollën e mesme 9 vjeçare Levan, Fier. Shpërndarja e tyre po dhe e parave në këmbim të votës bëhej me makina private dhe ndonjëherë edhe me mjetet e Kryqit të Kuq Dega Fier. Shtetasi Astrit Haxhaj, në fakt ka marrë disa herë ndihma në formë pakosh të vogla ushqimore si dhe shtetas të tjerë, varfëria e të cilëve shfrytëzohej për të manipuluar dhe tjetërsuar vullnetin e tyre, nuk do të dëshiroja ti pranoja se si persona të cilët gjenden në një situatë aspak të favorshme mund të bien pre e aktiviteteve dhe veprimtarive të paligjshme, siç është rasti konkret. Megjithatë ajo që mbetet fakt i denoncuar nga ana jonë dhe me shpresë i hetuar dhe me rezultate të shpejta dhe nga ana e prokurorisë është fakti se shtetasit: Mimoza Celibashi, Agim Celibashi, Shpëtim Duraj, Feti Caka janë shtetas të cilët shpërndanin ndihma ushqimore dhe para në favor të subjektit politik Partia Socialiste, në Bashkinë Fier. Në datën 27 Mars 2021, Partia Demokratike e Shqipërisë, ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Marjol Sina, Administrator i Agro Sina shpk dhe Këshilltar në Këshillin Bashkiak Lushnje. Ky shtetas kontakton klientët e biznesit të tij Agro Sina sh.p.k. duke u premtuar para dhe përfitime materiale si agroinpute, plehra kimike në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

këmbim të premtimit për të votuar Partinë Socialiste të Shqipërisë. Në datën 18 Mars 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasve Zhaklin Nurçe, Drejtor i INUK për Jugun dhe Alketa Marku (Nurce), punonjëse e Zyrës së Gjendjes Civile në Bashkinë Lushnje. Shtetasi Zhaklin Nurçe me detyrë Drejtor i INUK për Jugun e Shqipërisë që përdorte dhe një emër të dytë. Me këtë emër ky shtetas është dënuar për veprat penale të shfrytëzimit të prostitucionit dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike në shtetet e BE, konkretisht Itali dhe Belgjikë. Këtë fakt ky shtetas nuk e ka deklaruar asnjëherë në formularin e vetdeklarimit, apo nohur ndryshe në formularin e dekriminalizimit. Ky shtetas, pavarësisht se është dënuar për në nga krimet më të rëndë siç është prostitucioi, ushtron detyrën e INUK-ut për Jugun e Shqipërisë dhe njëkohësisht ishte angazhuar në blerjen masive të votave në Bashkinë Lushnjë kryesisht në zonat periferike duke shfrytëzuar kushtet ekonomike të vështira të qytetarëve të atyre zonave në favor të subjektit politik Partinë Socialiste dhe kandidates për deputete të kësaj force, shtetases Tatiana Piro. Ky shtetas përveç ofrimit të parave në këmbim të votës ofront edhe favore në drejtim të favorizimit të ndërtimeve pa leje në bashkëpunim me një firmë private Llazo sh.p.k. Në datën 19 Mars 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Zhezmi Zylali, Inspektor i Policisë Ndërtimore në Bashkinë Lushnje. Me datë 22.03.2021 dhe në vazhdim, ky shtetas, i cili kishte një supermarket në lagjen “Kadri Qystri” në Bashkinë Lushnje, shpërndante ndihma ushqimore dhe njëkohësisht falte borxhet që klientët të caktuar kishin tek ky supermarket në këmbim të mbështetjes dhe votave për Partinë Socialiste. Gjithashtu ky shtetas i ka ofruar qytetarëve të ndryshëm edhe para në këmbim të mbështetjes për Partinë Socialiste dhe kandidatëve të saj në Qarkun e Fierit. Në datën 24 Mars 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasve Kristina Gobere, me


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

detyrë Këshilltare e Bashkisë Divjakë, Haki Halili, kryeplak i fshatit Cermë Shkumbin, dhe Gjyljana Bali, përgjegjëse e qendrës shëndetësore Cermë. Shtetasja Kristina Gobere me detyrë anëtare e Këshillit Bashkiak Divjakë dhe kryeplak i këtij fshati në bashkëpunim me mjeken njëkohësisht Përgjegjëse e qendrës Shëndetësore Cermë Sektor ishin angazhuar në aktivitete të shumta të blerjes së votës dhe manipulimit të vullnetit të zgjedhësve në këtë zonë. Nga ana tjetër këta persona njihen për lidhje të shumëfishta me krimin e organizuar dhe me banda të caktuara, të cilat ne kemi pas mundësinë t'i citojmë në kërkesën tonë ankimore e po ashtu janë persona që kanë vuajtur dënimin me burg për vepra penale nga më të ndryshmet siç është dhe vepra penale e pjesmarrjes në organizata kriminale. Këta shtetas në fakt, për shkak të detyrave të tyre publike dhe lidhjeve me drejtues të lartë publikë të Partisë Socialiste, kërcënonin, intimidonin dhe shantazhonin punonjësit e administratës shtetërore në këto zona, që do të largoheshin nga detyra në qoftë se nuk do të ofronin përfitime dhe favore për mbështetësit e Partisë Socialiste, apo nuk angazhoheshin drejtë për drejtë në fushatë elektorale në favor të kësaj partie. Nga ana tjetër këta shtetas janë denoncuar publikisht dhe në prokurori, pasi mbledhnin kartat e identitetit të personave që premtonin se do të votojnë Partinë Socialiste duke u premtuar shpërblime në të holla, vende punë etj. Të gjitha këto veprime janë denoncuar nga ana e Partisë Demokratike në kallëzimin penal të datës 24 mars 2021, i cili i është vënë në dispozicion edhe këtij komisioni. Të gjitha këto fakte të sipër cituara, të provuara dhe faktuara gjenden në kërkesën e kësaj ankese. Faktet dhe grup-faktet e paraqitura provojnë katërcipërisht shkelje të rënda të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor me qëllimin e qartë për të ndikuar mbi rezultatin zgjedhor dhe ndarjen e mandateve në Qrkun e Fierit. Partia Demokratike ka denoncuar në mënyrë të vazhdueshme faktin se në zonën zgjedhore Qarku Fier nuk


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

kishte përballë saj një parti politike dhe kandidatët e saj që garonin me një ofertë politike, por grupe të strukturuar dhe banda kriminale që blinin vota, kërcënonin qytetarët, intimidonin nëpunësit publikë, shpërndanin leje legalizimi/ndërtimi, licensa, shpërblime dhe prokurime publike. Shitblerja e votës është një ndër problematikat kryesore të konstatuara edhe në Deklaratën e Gjetjeve dhe Rekomandimeve Paraprake të Misionit Ndërkombëtarë të Vëzhguesve të OSBE/ODIHR. Konkretisht, në raport thuhet praktikat gjërësisht të përhapura të shitblerjes së vota vazhduan të përbënin problem. Akuzat për shitblerje votash ishin konstante gjatë fushatës, duke treguar se ky vazhdoi të përbëntë një problem gjërësisht të përhapur. Struktura e Posacme e Anti-Korrupsionit (SPAK) e infomoi MKVZ-në e ODIHR-it se deri më 24 prill 2021, kishte hapur më shumë se 30 çështje që lidheshin me shitblerjen e votës. Po ashtu janë informuar raste konkrete në qarqe të ndryshme që kishin të bënin gjithashtu me incidente të shitblerjes së votave. Nga ana tjetër MKVZ-ja e OSBE/ODIHR-it mori raportime të besueshme se koordinatorët e fushatës së partive më të mëdha i ishin afruar një numri të konsiderueshëm zgjedhësish nga komunitetet rome dhe egjiptiane për t'u blerë votat. OJQ-të rome raportuan se kjo praktikë është e zakonshme dhe se shumë votues do t'i shisnin votat, të shtyrë nga gjendja e tyre ekonomike. Në disa qarqe, MNVZ-ja vuri re grupe djemsh të mbledhur jashtë qendrave të votimit, që dukeshin sikur kontrollonin zonë dhe shihnin se kush votonte. Në qarkun e Shkodrës, vëzhguesit vunë re një person që tërhoqte dikë tjetër për ta futurë në qendrën e votimit, dhe, në momentin që ky i dyti ishte brenda qendrës së votimit, u udhëzua për kë të votonte. Po në këtë qark, MNVZ-ja qe dëshmitare e një rasti të shpërndarjes së parave në një qendër votimi. Për sa i përket blerjes së votës nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera, Partia Demokratike Shqipërisë ka vendosur në dispozicion 12

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

prova. Në Qarkun e Fierit janë konstatuar në disa raste në mënyrë të përsëritur përdorimi i makinacioneve të dhënies së ndihmave ushqimore për familjet në nevojë për qëllime zgjedhore. Partia Demokratike për këto gjetje, për këto shkelje, për këto të dhëna, ka bërë disa kallëzime penale të cilat i ka vendosur bashkëlidhur kërkesës tonë ankimore dhe që do të citohen nga ana ime si vijon:

Në datën 13 Prill 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Fredi Kokoneshi, Kryetar i Bashkisë Divjakë, ky shtetas në bashkëpunim edhe me punonjës të tjerë të Bashkisë Divjakë si dhe të në këmbim të premtimit për të votuar subjektin elektoral Partia Socialiste ka shpërndarë tollona naftë për militantë dhe mbështetës të Partisë Socialiste në këmbim të angazhimit dhe votimit për këtë subjekt elektoral. Në datën 18 Mars 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasve Avni Snalla, Nën Kryetari i Bashkisë Divjak, Avni Sulo, Administrator i Njësisë Terbuf, Eris Stambolliu, Zv. Drejtor i ASHK-së, Ahmet Biba, punonjës Kadastre në Bashkinë Divjakë, Dorian Spaho, Drejtor Kadastre në Bashkinë Divjakë, dhe Eltinor Mahmutaj, Drejtor Rajonal i Bujqësisë. Prej disa ditësh në territorin e rrethit Lushnje por edhe Qarkun Fier punonjësit e bashkive, pamvarsisht pozicionit organik, punonjësit e ADISAS, ASHK-së, Tatimeve, Drejtoria Rajonale Bujqësisë janë parë, janë konstatuar duke zhvilluar veprimtari politike në favor të subjektit politik Partia Socialiste nën kërcënimin e vendit të punës prej drejtuesve të institucioneve përkatëse, derë me derë duke trokitur te fermeret duke u kërkuar votën për Partinë Socialiste dhe në këmbim u premtojnë e plotësojnë formularin dhe dokumentacionin për pajisjen me kartën e fermerit për rimbursim të naftës. Gjithashtu për të realizuar këtë projekt u shty edhe afati i regjistrimit të fermerëve nga 26 shkurt në 30 mars. Nga ana e Partisë Demokratike është kallëzuar në mënyrë të vazhdueshme se edhe Zv.kryeministri dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

kandidati për deputet zoti Erjon Braçe dhe Ministria e Bujqësisë, shtetasja Milva Ikonimi kanë qenë prezent në Lushnje për të ndjekur këtë veprimtari antiligjore e abuzuese. Për këtë Partia Demokratike i ka vendosur në dispozicion të këtij komisioni me të gjitha faktet në dispozicion me çdo të dhënë, me çdo indicie, kallëzimin penal të datës 18 mars 2021. Në datën 01 Prill 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasve Sadush Bali, Astrit Meca, Dajlan Debinja, Maksim Feracaku, Kastriot Molla, Seit Molla, Altin Shehu. Shtetasit e sipërpërmendur në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe nën drejtimin e shefit të Komisarariatit të mëparshëm dhe shefit të Komisarariatit aktual kanë zhvilluar veprimtari në mbështetje të subjektit politik Partia Socialiste. Këta persona ofrojnë lehtësi për pronarët e lokaleve dhe subjekte të veprimtarisë së tyre në këmbim të premtimit për të votuar Partinë Socialiste. Nga ana tjetër duke përdorur pushtetin e tyre dhe funksionet publike këta shtetas kanë penguar aktivitetin politik dhe ekonomik dhe kanë ushtruar presion ndaj personave të njohur si përkrahës të Partisë Demokratike që të hiqnin dorë nga këto aktivitete se në rast të kundërt ndaj tyre do të merreshin masa. Kallëzimi penal në fjalë është pjesë e provave të paraqitura në kërkesën tonë ankimore të datës 9 maj 2021 për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku Fier. Në datën 18 Mars 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Ardit Janko, inxhinier në ASHK-në Lushnje. Shtetasi Ardit Janko me detyrë inxhinier në agjensinë e Kadastrës në qytetin e Lushnjës, i ofronte favore qytetarëve të ndryshëm në bashkinë Lushnje duke i regjistruar pronat në këmbim të votës, për subjektin elektoral të parties Socialiste. Ky shtetas përdor vulën dhe licensën e e një topografi i cili është cituar nga ana jonë, duke e përdorur në mënyrë abuzive për të bërë dokumentacionin e tokës shtetasve të ndryshëm në favor të votës për Partinë Socialiste. Kallëzimi penal


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

i datës 18 mars 2021 I është vendosur në dispozicion këtij komisioni si pjesë e provave të depozituara së bashku me kërkesën tonë ankimore të datës 9 Maj 2021. Në datën 16 Prill 2021, Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Baftjar Zeqa ish-kryetar Bashkisë Fier dhe kandidat për deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Konkretisht ne kemi denoncuar faktin se ky shtetas duke përdorur automjetet, apo burime që kishte kompania publike Albpetrol kryente shërbime të ndryshme në Njësinë Administrative Strum, Bashkia Roskovec. Qartazi këto aktivitete nuk kishin qëllim tjetër, nuk kishin të bënin me përkujdesjen që shteti duhet të ketë ndaj qytetarëve të tij pasi shtetasi Baftjar Zeqa nuk ushtronte aktualisht ndonjë funksion publik, përveç se është administrator i përgjithshëm i shoqërisë Alpetrol, por me qëllim të pastër manipulimit dhe tjetërsimit e zgjedhësve për të votuar subjektin elektorale Partia Socialiste e Shqipërisë. Në datën 23 Prill 2021, Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasve Arian Faskaj, Drejtor i OSHEE, Taulant Saliq dhe Gëzim Bendaj. Këta shtetas duke përdorur autoritetin e tyre si dhe burimet publike të agjensive shtetërore që drejtonin shpërndanin ndihma ushqimore dhe para në këmbim të premtimit për të votuar subjektin elektroal Partia Socialiste e Shqipërisë. Në datën 20 Mars 2021, Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasve Armando Subashi, Kryetar i Bashkisë Fier, Shpëtim Duraj, punonjës i Bashkisë Fier. Shtetasi Eli Jani banues në Fier Sheq me urdhër dhe porosi të Kryetarit të Bashkisë Fier Armando Subashi shpërndan ndihma ushqimore. Këto ndihma ndahen në zona të cilat ne i kemi cituar në kërkesën tonë ankimore. Ato kishin për qëllim të shfrytzojnë gjendjen e vështirë ekonomike apo varërinë e nerëzve, për t'i manipuluar dhe tjetërsuar vullnetin në zgjedhjet parlamentare të 5 prillit. Në datën 18 Prill 2021, Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasve

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Fatos Tushe, Kryetar i Bashkisë Lushnje, Oli Sharka, Kordinatore e Partisë Socialiste për lagjen “Loni Dhamo” Lushnje. Këta shtetas përdornin fondet e ndihmës sociale për komunitetet në nevojë në zonën e Lagjes Loni Dhamo me qëllim sigurimin e premtimit për të votuar Partinë Socialiste. E gjithë kjo veprimtari kryhej nëpërmjet shtetases Oli Sharka dhe shtetasi Bujar Sharka i cili është i shoqi dhe nëkohësisht punonjës i policisë së shtetit. Këa shtetas kërcënonin banorët se në qoftë se nuk shkonin për të votuar Partinë Socialiste atyre do tu hiqet ndihma ekonomike dhe në të kundërt nqs votonin Partinë Socialiste do t’u shpërndareshin ndihma, bonuse dhe do të kishin përfitime të tjera. Ne kemi denoncuar faktet, vendet, personat, kohën kur është kryer shpërndarja e ushqimeve në këmbim të votës. Ndërkohë Znj. Antoneta Dhima, kandidatja për deputete e Qarkut Fier ka shpërndarë në faqen e saj të Facebook foto nga fushata e saj e donacioneve elektorale me qëllimin e vetëm tjetërsimin e vullnetit të qytetarëve të Qarkut Fier për të votuar kandidaturën e saj dhe atë të Partisë Socialiste. Besoj se të gjithë ne që kemi ndjekur fushatën elektorale të 25 prillit, ndoshta dhe ky komision, ka pasur mundësi të konstatojë se si në rrjetet sociale por dhe në mediat on-line, u bënë virale disa foto ku pako ushqimore shfaqeshin me emrin e kandidatës për deputete Antoneta Dhima. Po ashtu në kërkesën tonë ankimore, kemi cituar në faqen 13 dhe 14 disa vendime të Këshillit të Ministrave të cilat synonin të sillnin përfitime për kategori të caktuara shoqërore. Për sa takon vendosjes së shtetit në shërbim të partisë, duke përdorur në mënyrë të paligjshme burimet shtetërore për devijimin e vullnetit të zgjedhësve Partia Demokratike dhe Aleanca për Ndryshim ka vendosur në dispozicion të këtij komisioni 30 Prova. Së pari, shteti vendosi investimet publike, indimidoi administratën shtetërore dhe përdori në mënyrë të paligjshme burimet shtetërore në funksion të PS për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit. Gjatë fushatës u konstatuan

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

raste të shumta, të cilat janë denoncuar vazhdimisht nga Partia Demokratike se si të gjitha nivelet e administratës qendrore dhe vendore ishin përfshirë në fushatë, duke mbështetur publikisht kandidatët e PS-së. Drejtoritë vendore arsimore, drejtoritë vendore të bujqësisë, spitalet rajonale, shkollat e mesme, agjencitë vendore të kadastrës, administratat e policisë dhe burgjeve, gjendja civile si dhe një numër shumë i madh institucionesh të ndryshme, u kthyen gjatë fushatës zgjedhore në shtabe elektorale të PS-së. Nëpunësit civilë ishin nën presion të vazhdueshëm për të mbështetur kandidatët socialistë, në të kundërt mund të shkarkoheshin nga detyra. Konkretisht, nëpunësve civilë iu kërkua: pjesëmarrje e detyruar në takime elektorale, dorëzimi i listës me votuesit në familjet e tyre, dhënia e kartave të identitetit dhe të dhënave të tjera personale, shpërndarja e postimeve në rrjetet sociale, përfshirja në fushatën derë më derë, dhënia e përfitimeve të ndryshme për simpatizantët e Partisë Socialiste. Nëpunës, të niveleve të ulëta dhe të mesme, të Autoritetit Rrugor Shqiptar jo vetëm në Qarkun e Fierit, por kudho në Shqipëri, kanë denoncuar presionin e vazhdueshëm nga eprorët e tyre për të paraqitur një listë me 30 deri në 50 votues për Partinë Socialiste (emrat dhe kartat e identitetit) ose përndryshe do të përballeshin me masa disiplinore. Në Qarkun e Fierit janë evidentuar të paktën 32 raste të përdorimit të investimeve publike, intimidimit të administratës shtetërore apo përdorimit të paligjshëm të burimeve shtetërore në funksion të PS, partisë-shtet gjatë zgjedhjeve të cilat PD i ka denoncuar pranë Prokurorive përkatëse të Rretheve, si vijon:

Në datën 17 Prill 2021, Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar një ankesë pranë Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat Tiranë kundrejt shtetasit Altin Shehu, Shefi i Komisarariatit Divjakë dhe shtetasit Dalan Debinja, punonjës në Komisariatin e Policisë Divjakë ishin përfshirë në aktivitete elektorale të Partisë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Socialiste. I gjithë ky aktivitet sigurisht në kundërshtim me ligjin i cili ndalon përfshirjen në aktivitete elektorale. Kemi rastin konkret mbështetjen e tyre ndaj kandidatit për deputet dhe zv.kryeministër zotit Erjon Braçe. Në datën 10 Prill 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Fredi Kokoneshi, Kryetar i Bashkisë Divjakë, pasi ky shtetas duke përdorur fondet dhe mjetet e Bashkise Divjakë kryen investime ne rrugët e fshatrave Hallvaxhias, Bregas, Dushk Can pa respektuar procedurat ligjore, tabela në lidhje me transparencën e këtyre fondeve dhe të gjitha këto në këmbim të votimit për subjektin politik Partia Socialiste. Në datën 13 Prill 2021, Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Fredi Kokoneshi, Kryetar i Bashkisë Divjakë. Ky shtetas duke përdorur fondet dhe mjetet e Bashkisë Divjakë kryen investime në rrugët e fshatrave Cermë e sipërme, Grabjan pa respektuar procedurat ligjore, tabela në lidhje me transparencën e këtyre fondeve dhe me qëllimin e vetëm për të influencuar dhe ndikuar te votat e zonave përkatëse. Në datën 17 Prill 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Fredi Kokoneshi, Kryetar i Bashkisë Divjakë. Më datë 16.04.2021 janë konstatuar kamionat dhe mjetet e rënda të Bashkisë Divjakë hedhin inerte, zhavorr, stabilizantë e baltë në dukje, në rrugët e fshatit Karavasta, Njësia Administrative Rreman Bashkia Divjakë, pa asnjë procedurë të prokurimit publik. Qartazi pra të gjitha investime me qëllim të pastër manipulimin dhe tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve në këtë zonë. Në datën 17 Prill 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Fredi Kokoneshi, Kryetar i Bashkisë Divjakë. Pasi ky shtetas ka lejuar, ka nxitur dhe ka marrë pjesë dhe vetë zhvillimin e fushatës elektorale në ambientet shkollore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Divjakë në mbështetje të subjektit elektoral Partia Socialiste dhe posaçërisht kandidatit për deputet Zv/Kryeministrit aktual Erion


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Braçe. Në faqet 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21 ka në fakt një numër shumë të madh kallëzimesh të cilat Partia Demokratike ka depozituar ndaj përfaqësuesve të pushtetit vendor apo qendror, të gjithë përfaqësues dhe drejtues zyrtarë të lartë të Partisë Socialiste që kanë të bëjnë me përdorimin e fondeve, aseteve dhe burimeve shtetërore në favor të Partisë Socialiste të Shqipërisë. Sigurisht që ne i kemi cituar, kemi vendosur bashkëlidhur dhe provat përkatëse që i mbështesnin këto kallzime me të cilat shpresojmë që komisioni ka pasur mundësi të njihet edhe pse në fakt materialet janë goxha voluminose dhe meritonin në vlerësimin tonë një shërbim të posaçëm dhe të kujdesshëm të tyre. Në referim të fakteve dhe grup fakteve, është e qartë se investimet publike, intimidimi i administratës dhe përdorimi i paligjshëm i burimeve shtetërore u përdorën në mënyrë sistematike nga Partia Socialiste me qëllimin e vetëm për të ndryshuar vullnetin e votuesve në një masë aq të gjerë sa këto akte kanë ndikuar drejtëpërdrejtë në shpërndarjen e mandateve në këtë qark. Përdorimi i burimeve shtetërore për fushatë evidentohet edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR. Konkretisht, Misioni shprehet se pavarësisht një kuadri ligjor solid që ndalon shpërdorimin e burimeve administrative dhe minimizon avantazhin e partisë në pushtet, ministrat vazhduan të bënin fushatë gjatë angazhimeve zyrtare. Publiciteti që erdhi si pasojë e kësaj i dha partisë qeverisëse një avantazh të konsiderueshëm. Kallzimet e shumta dhe faktet e shumta të cilat Partia Demokratike i ka bashkëlidhur kërkesës së saj ankimore dëshmojnë në fakt se çdo investim publik dhe çdo punë e bërë publike gjatë periudhës janar – prill 2021, u shfrytëzua nga drejtuesit, përfaqësuesit, kandidatët e Partisë Socialiste në Qarkun e Fierit vetëm e vetëm me qëllim manipulimin dhe tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve në këtë qark. Po ashtu Partia Demokratike ka depozituar 8 prova të cilat demostrojnë se dhe punësimet e reja në administratën publike, të cilat ishin shkelje e rëndë e ligjit për

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

përfitim politik duke devijuar vullnetin e zgjedhësve. Ashtu siç kemi pasur mundësi të relatojmë dhe parashtrojmë edhe në qarqet e tjera, vetëm në katër muaj punësimi në administratën publike sipas të dhënave zyrtare të Institutit të Statistikave u rrit me rreth 13 mijë punonjës. Megjithatë ajo që ka rëndësi në shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore është që të ndalemi dhe të shqyrtojmë disa të dhëna konkrete të cilat lidhen drejt për drejtë me Qarkun e Fierit. Sigurisht të dhënat që ne kemi pasur në dispozicion janë në një numër të kufizuar. Megjithatë një hetim i plotë dhe i gjithanshëm do të kërkonte që nga ana e këtij komisioni të pranoheshin kërkesat tona për marrje provash shtesë pranë organeve të administratës publike. Në datën 30 Mars 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Arjan Faska me detyrë Drejtor i OSHEE për Jugun. Ky shtetas ka punësuar rreth 80 persona në këmbim të premtimit prej tyre për të votuar Partinë Socialiste kryesisht në zonat e Cakranit dhe Kreshpanit. Mes personave të punësuar gjatë periudhës parazgjedhore duke premtuar se do të votojnë Partinë Socialiste ne kemi cituar një numër të lartë shtetasish të cilët gjenden në faqen nr.23, por për shkak se me këta shtetas nuk kemi se si të kemi asgjë personale për shkak se mund ta mirëkuptojmë edhe gjendjen e tyre të vështirë ndoshta ekonomike, por ajo që mbetet e paligjshme dhe kriminale është se si shtetasi Arjan Faskaj duke përdorur funksionin e tij publik punësonte në administratë publike, njerëz të ndryshëm duke ju premtuar dhe duke u kërkuar atyre në fakt që të jepnin votën në favor të Partisë Socialiste. Megjithatë ky shtetas nuk është ndaluar vetëm marrjen e votave në këmbim të vendeve të punës, por fakte dhe prova konkrete të cilat ne i kemi depozituar së bashku me kallëzimin tonë penal, flasin se ky shtetas ka shpërndarë edhe para dhe ndihma të tjera ushqimore në mënyrë që të siguronte vota për Partinë Socialiste të Shqipërisë. Po ashtu në datën 17 Mars 2021, Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar një kallëzim penal

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

ndaj shtetasit Baftjar Zeqaj, kandidat për deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Shtetasi Baftjar Zeqo në kohën që ka qënë Administrator i Kompanisë Albpetrol Sh.a. ka punësuar qindra persona banorë të Bashkive Fier, Patos e Roskovec. Punësimi i këtyre personave është bërë në këmbim të premtimit të marrë prej tyre për tu angazhuar në aktivitetin politik të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë. Shtetasve të punësuar u është kërkuar që të garantojnë edhe dhënien e votës të atyre vetë dhe familjarëve të tyre për Partinë Socialiste në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të datë 25 Prill 2021. Në datën 24 Mars 2021, Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasve Petrit Kanani, Drejtor në Bashkinë Fier, Sokol Dana, punonjës i Bashkisë Fier, Astrit Haxhaj, punonjës i Bashkisë Fier. Në fshatin Qarrë shtetasi Petrit Kanani i cili ushtron detyrën e Drejtorit në Bashkinë Fier ka kontaktuar banorë të ndryshëm të këtij fshati duke i kërkuar që të angazhohen në aktivitet elektorale për Partinë Socialiste nën kërcënimin se në rast të kundërt ndaj tyre do të përdoren tërë atributet shtetërore për t'u mohuar të drejtat e tyre për subvencionet për shkak se këta shtetas janë të angazhuar në veprimtari bujqësore. Ky shtetas personave të cilët kanë premtuar se do të votojnë për Partinë Socialiste i ka punësuar në Bashkinë Fier me rrogë minimale 26000 lekë dhe kontrata pune 3 mujore si shpërblim të angazhimit të tyre dhe premtimit për të votuar Partinë Socialiste. Këto emërimet ky shtetas i ka bërë edhe në fshatin Shtyllas të Bashkisë Fier. Po ashtu në datën 17 Prill 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Arjan Fasko, Drejtor i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Pasi ky shtetas ka punësuar në këmbim të premtimit se do të votojnë për subjektin politik Partia Socialiste shumë persona banorë të fshatit Buzmadh, Cakran, në ndërmarrjen e drejtuar prej tij. Këta shtetas janë cituar në kërkesën tonë ankimore. Sigurisht që informacioni i siguruar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, ka qënë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

me numër të kufizuar për shkak se informacionet e plota disponohen nga institucionet shtetërore dhe një zbardhje e plotë e numërit të të punësuarve në këto agjensi publike dhe kompani shtetërore që veprojnë në Qarkun e Fierit do të kërkonte dhe marrjen e provave të kërkuara nga ne dhe besoj se në një moment tjetër procedural do të kemi mundësi ti citojmë. Në datën 24 Mars 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Qerim Ismailja, Kryetarit të Bashkisë Mallakastër. Ky shtetas ka punësuar gjatë periudhës Janar – Prill 2021 një numër të lartë personash (të paktën 23 nga informacionet bashkëlidhur kallëzimit) me kontrata të përkohshme pune kryesisht tre mujore në këmbim të premtimit të marrë prej tyre se do të votojnë subjektin politik Partia Socialiste dhe janë kërcënuar se në rast të humbjes së Partisë Socialiste do ti largojë nga puna. Në datën 18 Mars 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetases Majlinda Bufi, Kryetare e Bashkisë Roskovec. Kjo shtetase duke shfrytëzuar postin e saj publik ka zgjeruar numrin e administratës publike duke bërë kështu punësime elektorale me qëllimin për të ndikuar në mënyrë direkte te vullneti i votuesve të Bashkisë Roskovec. Ajo gjithashtu ka ushtruar presion ndaj punonjësve të saj për të mbledhur kartat e identitetit të familjarëve. Sa i përket dhënies së lejeve të legalizimit/ndërtimit gjatë fushatës zgjedhore si dhe veprimtari të tjera të ndaluara, Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar 10 prova. Deputetë të ndryshëm të Partisë Socialiste shpërndanë leje legalizimi në kundërshtim me përcaktimin e Kodit Zgjedhor dhe Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së. Ka të paktën 9 raste në Qarkun Fier, për të cilat Partia Demokratike ka depozituar edhe kallëzimet penale përkatëse të cilat do të citohen në vijim të kësaj kërkesë ankimore. Meqenëse patëm mundësi ta citojmë gjerësisht aktivitetin e paligjshëm të shtetasit Altin Shehu, Shefi i Komisariatit Divjakë, por dhe shtetasit Ymer Cer Kokja, Ramiz

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Kubolli, Ervis Lala. Këta shtetas kanë premtuar dhe kanë kryer veprimtari të paligjshme me qëllim tjetërsimin dhe manipulimin e vullnetit të zgjedhësve. Përfshirë këtu edhe lejimin për të ndërtuar në mënyrë të paligjshme të shtetasve të ndryshëm të cilët kishin premtuar dhënien e votës së tyre në favor të Partisë Socialiste. Po ashtu Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasit Fredi Kokoneshi, Kryetar i Bashkisë Divjakë, pasi ky shtetas në bashkëpunim edhe me punonjës të tjerë të Bashkisë Divjakë si dhe të ASHK-së në këmbim të premtimit për të votuar subjektin elektoral Partia Socialiste ka shpërndarë leje legalizimi gjatë muajit prill për disa shtetas të cilët janë cituar në faqen 25 të materialit tonë ankimor. Shtetas të tjerë të cilët janë përfshirë në shpërndarjen e lejeve të legalizimeve, apo kanë lejuar ndërtime të paligjshme janë cituar në faqen 25, 26 dhe 27 të kërkesës sonë ankimore të cilat vlerësojmë se nga ana e këtij komisioni kanë pasur kohën e mjaftueshme për t'u shqyrtuar siç u tha dhe nga relatori i çështjes. Për sa i përket përdorimit të paligjshëm të të dhënave personale ku në fakt shteti vendosi të dhënat personale në dispozicion të serverave të PS jo vetëm në Tiranë ku faktet dolën dhe u bënë publike por dhe në të gjithë qarqet e vendit siç provohet dhe nga deklaratat e bëra publike nga drejtues të Partisë Socialiste, duke përfshirë Qarkun Fier. Është fakt publik se drejtues dhe përfaqësues të Partisë Socialiste duke filluar nga Kryetari i saj, sekretari i përgjithshëm, drejtuesit politikë të qarkut, falenderuan në mënyrë të përsëritur patronazhistët për shërbimin e madh që i kishin bërë kësaj partie në zgjedhjet e 25 prillit. Mbledhja, përdorimi, përpunimi I të dhënave personale pa pëlqimin e personit dhe aq më tepër publikimin e tyre, janë shkelje flagrante e neni 35 të Kushtetutës së Shqipërisë, neni 8 të Konventës Europiane për të drejtat e njeriut dhe ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Po ashtu ne kemi pasur mundësi të relatojmë gjerësisht dhe në kërkesat e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

tjera ankimore, por është fakt i rëndësishëm dhe si i tillë duhet të dalë. Rrjedhja e të dhënave personale sensitive ishte një nga shqetësimet kryesore që u paraqit edhe në Raportin paraprak të OSBE/ODIHR. Po ashtu për sa i përket mohimi i të drejtës për të votuar i emigrantëve:

Deri në datën 19.04.2021, të gjithë ne që jemi këtu, jemi dëshmitarë që nuk ka pasur asnjë ndalim që emigrantët shqiptarë, të hynin në Shqipëri në vendlindjen e tyre dhe të vendoseshin në karantinë. Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë, vetëm 1 javë para zgjedhjeve, nxori një vendim që detyronte emigrantet që vinin nga Greqia apo Maqedonia e Veriut të karantinoreshin detyrimisht për një periudhë 2-javore. Ky vendim pengonte efektivisht mbi 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës, në mënyrë diskriminuuese. Pavarësisht se nenet 24 dhe 25 përcaktojnë të drejtën e shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë Shqipërisë, për të votuar aty ku ata jetojnë, administrata zgjedhore nuk bëri asgjë që të garantonte efektivisht këtë të drejtë. Sipas të dhënave të INSTAT-it për vitin 2020, numri i shtetasve shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në Greqi dhe Maqednin Veriut është rreth 500 mijë shtetas. Është për t'u evidentuar fakti se vetëm 1 javë pas zgjedhjeve, pra 3 Maj 2021 detyrimi për t'u karantinuar i emigrantëve u shfuqizua.

Mohimi i të drejtës për të votuar i shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë u evidentua edhe në Raportin paraprak të OSBE/ODIHR. Konkretisht, Misioni shprehet se megjithëse në Kodin Zgjedhor parashikohet si mundësi, qytetarëve nuk iu ofrua mundësia për të votuar jashtë vendit. Megjithatë, votuesit që jetojnë jashtë mund të kthehen dhe të votojnë në qendrat përkatëse të votimit, megjithëse në praktikë, kjo mund të jetë penguar nga masat e marra për shkak të COVID-19. 7). Një numër i konsiderueshëm zgjedhësish jetojnë jashtë vendit. Shumica e tyre nuk

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

mundën të votojnë për shkak të mundësisë për të votuar jashtë shtetit dhe kufizimeve të vendosura ndaj udhëtimeve për shkak të COVID-19. Për sa i përket mohimit të të drejtës për të votuar të infektuarve me COVID-19: Zgjedhësit që ishin infektuar me COVID-19 dhe që ndodheshin në karantinë, qenë të detyruar të respektonin rregullat e izolimit, duke çuar de facto në mohimin e së drejtës së tyre për të votuar. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, numri i personave të infektuar me COVID-19 në ditën e zgjedhjeve ishte rreth 23.000 shtetas, ndërkohë që vetëm në qytetin e Fierit ky numër ishte 1888 individë. Kjo praktikë bie ndesh përkatësisht me dispozitat për të drejtat e votimit dhe barazinë e votës të parashikuar në nenin 45 të Kushtetutës dhe siç thuhet me të drejtë në Raportin paraprak të OSBE/ODIHR dhe me paragrafin 7/2 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 të OSBE-së. Është fakt publik se ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor nga ana e Partisë Socialiste, ndikuan qartazi për të deformuar vullnetin e zgjedhësve në zgjedhjet e 25 Prillit 2021. Për këtë ne kemi depozituar gjithë praktikën përfshirë dhe vendimmarrjen e këtij komisioni i cili në vlerësimin tonë në kundërshtim të plotë me nenin 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikat 27 dhe 49 të praktikës së mirë të çështjeve zgjedhore të Komisionit të Venecias miratoi një fletë votimi e cila konfuzoi 83028 zgjedhës, ose 5% të numërit total të votuesve.

Përsa i përket numrit të madh të fletëve të votimit të pavlefshme:

Në 31.03.2021, Komisioneri Shtetëror miratoi fletët e votimit, e cila përmbante logon e partive, emrin e subjektit/koalicionit, emrin e kryetarit të partisë dhe emrat e kandidatëve për deputetë. Ky vendim i Komisionerit u ankimua nga Partia Socialiste, e cila kërkoi që fleta e votimit të ishte vetëm me numra, pa emrat e kandidatëve. Në datën 03.04.2021, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve vendosi

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

të pranojë ankimin e PS për të miratuar një fletë votimi vetëm me numra, pa emrat e kandidatëve. Ndaj këtij vendimi, u ushtrua ankim nga Partia Demokratike në Kolegjin Zgjedhor, i cili në 04.04.2021 vendosi të lerë në fuqi vendimin e KAS-it Kompania Celtics, e cila ishte ngarkuar me prodhimin e fletëve të votimit, informoi në të njëjtën ditë KQZ se afati 10-ditor për prodhimin e fletëve të votimit është “një mision i pamundur”, duke kërkuar minimalisht 20 ditë. Në kohën e shkurtër të mbetur në dispozicion nga dita e votimit, KQZ bëri një fushatë sensibilizuese mbi mënyrën se si qytetarët duhet të votonin që fleta e votimit të ishte e vlefshme. Megjithatë, kjo nuk e uli numrin e votave të pavlefshme, të cilat sipas të dhënave zyrtare të KQZ-së arritën në 83.028 vota ose 5% e totalit të numrit të votuesve. Ndërkohë vetëm për Qarkun Fier rezultuan 9375 fletë të pavlefshme ose 5.13%. Ky fakt u evidentua edhe në Deklaratën e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake, të publikuar në datën 25.04.2021 nga Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR, i cili konkretisht shprehet “...fushata e informimit të zgjedhësve ishte e pamjaftueshme dhe se kishte filluar me vonesë, sidomos sa i përket konfigurimit të ri të fletës së votimit”. Ky në fakt është një fakt që u pranua edhe në deklaratën publike që bëri pas zgjedhjeve Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, po e citoj “Nëse fleta e votimit do ishte me emra, ndoshta do ishte ndryshe. Por, vendimmarrja e KAS-it dhe Kolegjit vlerësoi që informacioni mund të ishte më i thjeshtë për votuesit. Kemi 83 mijë fletë votimi të pavlefshme. Para se KQZ t’i djegw ndoshta është mirë që të shohim ato fletë votimi që janë vlerësuar të pavlefshme, për çfarë arsye është”. Po ashtu strukturat e Partisë Demokratike, ashtu si në rastet e shqyrtimit të rasteve të tjera kanë denoncuar rastet e votimit të shumëfishtë. Konkretisht: nga informacionet që ne kemi marrë ka pas raste të votimit për të tretët, apo raste të votimit familjar, apo raste të fallsifikimit të mjeteve të identitetit që janë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

përdorur në ditën e zgjedhjeve të 25 Prillit 2021. Në përmbledhje të fakteve deri në datën 25.4.2021 del qartë se pati një blerje masive të votës në të gjitha njësitë administrative, lagjeve, bashkive, jo vetëm të qyteteve por në të gjithë zonën zgjedhore të Qarkut Fier. Pati një përdorim masiv të burimeve dhe asetëve publike të cilat u vunë gjitha ë ërdorim dhe në dpozicion të Partisë Socialiste. Kjo ishte të nderuar vetëm përsa i përket fakteve, ndërkohë që tani është koha të fillojmë relatimin ose parashtrimin e analizës sonë ligjore. Kodi Zgjedhor ka përcaktuar në mënyrë të detajuar cilat janë rastet kur zgjedhjet shpallen të pavlefshme, cili është organi kompetent dhe pasojat që sjell një vendim i tillë. Konkretisht, neni 160 parashikon se KQZ-ja i shpall zgjedhjet të pavlefshme kur tërësia e shkeljeve të ligjit mund të ketë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Një vendimmarrje e tillë, sipas neni 121, pika 1 është kompetencë ekskluzive e KAS-it. Në rast të marrjes së një vendimi për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një zonë zgjedhore, neni 161, pika 1 parashikon se KQZ-ja urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore. Për të vërtetuar paligjshmërinë e një veprimi të kryer, pra për të vërtetuar atë që parashikon Kodi Zgjedhor, nëse shkelja e ligjit ka qenë e tillë sa ka cënuar rëndë procesin zgjedhor apo nëse tërësia e shkeljeve të kryera ka qenë e atyre përmasave sa mund të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, KAS-i duhet të orientohet nga konceptet e përpunuara nga jurisprudenca gjyqësore mbi parimin e proporcionalitetit. Terminologjia “e rëndë” dhe ndikimi “në një masë të tillë”, i përdorur në nenin 160, pika 1, shkronja “a” të Kodit Zgjedhor, imponon kryerjen nga KAS-i të një vlerësimi të arsyeshëm, objektiv dhe të paanshëm mbi natyrën e shkeljes së ligjit. Kuptimi i saktë dhe i drejtë i terminologjisë së përdorur në këtë dispozitë ligjore, duhet të analizohet dhe vlerësohet në tërësi nga disa faktorë, që kanë të bëjnë me rëndësinë e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

shkeljes së ligjit, pasojat e ardhura apo që mund të vinin nga kjo shkelje. Në rastin konkret, Partia Demokratike, në emër të Koalicionit Aleanca për Ndryshim, do të parashtrrojë një numër të madh shkeljesh të Kushtetutës, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kodit të Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore dhe Kodit Zgjedhor, të cilat në tërësinë e tyre çënojnë rëndë procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikojnë drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Tërësia e këtyre shkeljeve krijon bindjen e plotë bazuar në fakte dhe prova të pakundërshtueshme, si dhe Kodin Zgjedhor, për shpalljen e pavlefshme dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Qarku Fier. Shkeljet ligjore lidhur me manipulimin e vullnetit të zgjedhësve nëpërmjet blerjes së votës, përdorimit të personave me precedentë kriminalë, dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera, si shkelje të ligjit që kanë çënuar rëndë procesin zgjedhor. Manipulimi i vullnetit të zgjedhësve nëpërmjet premtimit, ofrimit apo dhënies së përfitimeve monetare apo materiale, ashtu si edhe kërcënimi i votuesve, kanë qenë problematika të theksuara që kanë shoqëruar vazhdimisht proceset zgjedhore në Shqipëri, veçanërisht në 10 vitet e fundit. Në raportet ndërkombëtare për vëzhgimin e zgjedhjeve në Shqipëri, veçanërisht në raportet e OSBE/ODIHR, këto problematika vijnë të përsëritura dhe vazhdimisht ka rekomandime për të marrë masat e duhura ligjore dhe institucionale për luftimin e këtyre fenomeneve. Për luftimin me efikasitet të këtyre fenomeneve, legjislatori shqiptar, i asistuar nga ekspertiza ndërkombëtare e partnerëve tanë, ka miratuar ndryshime të vazhdueshme në Kodin Zgjedhor..

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kodin Penal dhe akte të shumta nënligjore që synojnë pikërisht adresimin e këtyre problematikave. Konkretisht neni 78 pika 7 e Kodit Zgjedhor parashikon ndalimin e subjekteve zgjedhore të ofrojnë ose japin të holla, të mira materiale , premtojnë vende pune apo favorizime të tjera me qëllim për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për t'u angazhuar në veprimtarinë e paligjshme në mbështetje të një kandidati. Ky parashikim i Kodit Zgjedhor është reflektuar sigurisht edhe në Kodin Penal i cili në nenin 328 parashikon se ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale premtimi për vende pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim votimin në një mënyrë të caktuar përbën veprë penale dhe dënohet me burg nga një deri në 5 vjet. Shpesh herë praktika e shitblerjes së votës është shoqëruar edhe me veprimtari të tjera të paligjshme të tilla si marrja e dokumentit të identifikimit për të mos lejuar votimin, kanosja e zgjedhësit apo detyrimi për të votuar në një mënyrë të caktuar nga një person që ushtron një funksion publik. Megjithatë ekzistenca e një legjislacioni solid për krimet zgjedhore më shumë është tregues i përmbushjes në letër të rekomandimeve në raportet ndërkombëtare lidhur me zgjedhjet në Shqipëri se sa një vullnet i mirëfilltë i partive politike. Megjithëse se tre partitë kryesore shqiptare, PS, PD dhe LSI arritën një dakordësi me ndryshimet e Korrikut 2020 në Kodin Zgjedhor të cilat gjithësesi u pasuan nga ndryshimet të tjera të një anshme nga ana Partia Socialiste fatkeqësisht edhe në zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit nuk munguan rastet flagrante të shitblerjes së votës, dhënies së ndihmave ushqimore apo kërcënimit të votuesve nga ana e drejtuesve përfaqësuesve apo mbështetësve të Partisë Socialiste. Shkeljet flagrante të Kushtetutës, Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Kodit të Praktikës së mirë në Çështjet Zgjedhore, Kodit Zgjedhor tërësia e veprimtarisë kriminale të kallëzuar gjatë periudhës zgjedhore. E dokumentuar sipas

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

29 provave të këtij ankimi do të analizohen në ditët në vijim. Së pari siç kemi pasur mundësi të shpjegojmë gjerësisht në seksionin ose në pjesën në rrethanat e çështjes Partia Demokratike e Shqipërisë nëpërmjet strukturave të saj në terren ka evidentuar dhe faktuar raste të shumta të shitblerjes së votës. Për të gjitha këto raste Partia Demokratike ka depozituar 50 kallzime në SPAK në 30 prej të cilave kanë të bëjnë pikërisht me shitblerje masive të votës. 130 kallzime të tjera në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm kanë të bëjnë po ashtu me krime zgjedhore. Në rastin e Qarkut Fier Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim në SPAK për rreth 50 zyrtarë të lartë të pushtetit qendror dhe vendorë persona me rekorde të tmerrshme kriminale të përfshirë drejtëpërdrejtë në blerjen e votave në favor të Partisë Socialiste. Vetëm në Qarkun e Fierit janë depozituar nga strukturat e Partisë Demokratike 74 kallzime penale, 74 kallzime penale, pjesa më e madhe e të cilave i përkasin Bashkisë Divjakë ku janë shfaqur problematikat më të mëdha të shitblerjes së votave. Rikujtoj këtu për anëtarët e nderuar të këtij komisioni se përgjegjësi për zonën e Bashkisë Divjakë është zv. Kryeministri shtetasi Erion Braçe. Por përveçse një veprimtari kriminale e cila duhet hetuar dhe dënuar nga organet e drejtësisë e ne nuk i kërkojmë kurrësi as i kemi kërkuar këtij komisioni të shëndërrohet në prokurori apo gjykat, blerja e votës përbën shkelje të rëndë të Kodit Zgjedhor. Duke cënuar procesin zgjedhor deri në atë masë sa në vlerësimin tonë sjellë, pavlefshmërinë e saj. Konkretisht neni 78 pika 7 e Kodit Zgjedhor parashikon shprehimisht ndalimin e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve për të ofruar ose të holla ose të mira materiale, premtime për vende pune, ose favorizimë të tjera të cilësdo formë me qëllim votimin në një mënyrë të caktuar ose marrjen pjesë në votime. Në rastin e Qarkut Fier kemi faktuar nëpërmjet 29 provave se persona me rekorde të tmerrshme kriminale drejtuesi politik i Qarkut Fier shtetasi Erion Braçe, shtetasi Altin Shehu, Shefi i Komisarariatit të Policisë Divjakë,


*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Rajmonda Balili Kryetare e Bashkisë Patos, Fredi Kokoneshi Kryetar i Bashkisë Divjakë, Zhaklin Nurçe drejtor i INUK për jugun, Avni Stalla nën kryetar i Bashkisë Divjakë dhe individ të tjerë me poste dhe funksione të larta pranë Partisë Socialiste janë përfshirë masivisht në blerjen e votave në zgjedhjet e 25 Prillit 2021. Qartësisht veprimtaria kriminale e blerjes së votës në Qarkun e Fierit ka cënuar rëndë procesin zgjedhor dhe ka ndikuar thelbësisht në ndarjen e mandatave çka do të thotë se në kuptim të nenit 160 kjo në fakt duhet të sjellë pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të gjitha QV e këtij qarku dhe gjithë zonën zgjedhore dhe përsëritjen e këtyre zgjedhjeve. Së dyti neni 91 pika 4 e Kodit Zgjedhor dhe neni 3 pika 3 vendimit nr. 9 . 2020 parashikojnë se 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisjes së re ndalohej propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nën ligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë si akte që parashikojnë rritjen e pagave, mbështetjes ekonomike, dhënien e shpërblimeve e tjerë. Megjithatë vetë qeveria në disa raste në të cilat ne kemi pasur mundësi t'i citojmë nëpërmjet vendimeve të cilat formalisht mbanin dastën 24 Dhjetor 2020 por çuditërisht publikoheshin ose në Jana ose në Shkurt 2021. Parashikonin shtesa në ndihmën ekonomike dhënie shpërblimesh të posaçme, rritje pagash, fonde të posaçme për bujqësinë dhe dëmshpërblime për fenomene të ndryshme natyrore me qëllimin e pastër, manipulimin dhe tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve nëpërmjet përfitimit dhe të drejtëpërdrejta. Kemi pasur mundësinë të relatojmë faktin dhe kemi kërkuar në fakt që të verifikohet deri në fund se punonjës të shoqërive të ndryshme aksionere siç është rasti i shoqërisë OSHEE.Sha përfituan paga shtesë për numër të konsiderueshëm punonjësish në këtë qark. Sa i përket kësaj pjese është e qartë se ndërtimi i një skeme kriminale e shtrirë në mënyrë kapilare në të gjithë Qarkun e Fierit për blerjen e votës, nëpërmjet përfshirjes së personave me rekorde të

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

tmerrshme kriminale apo duke dhënë bonuse dhe përfitime të tjera për qytetarët me qëllim ndikimin e drejtëpërdrejtë në vullnetin e tyre në favor të partisë shtet, përbën shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor duke cënuar rëndë këtë proces e për rrjedhojë duke ndikuar drejtëpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Dhënia e përfitimeve në të holla nga buxheti i shtetit ka synuar qartësisht manipulimin e vullnetit të zgjedhësve në favor të Partisë Socialiste. Numri i familjeve dhe i personave që kanë përfituar në mënyrë të drejtëpërdrejtë të holla është shumëfish më i lartë se numri i zgjedhësve që kanë ndarë mandatin ndërmjet Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike. Megjithatë në çdo rast është e qartë se shkeljt flagrante të ligjit, dhe në veçanti të neneve 78 dhe 91 të Kodit Zgjedhor edhe vendimit nr. 9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator pranë KQZ të kryer nga zyrtarë dhe drejtues të lartë të Partisë Socialiste duke marrë në konsideratë edhe intesitetin e tyre në të gjithë zonat zgjedhore të Qarkut Fier kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor, të cilat në vlerësimin tonë sigurisht kanë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve në këtë qark. Sa i përket analizës lidhur me shkeljet flagrante të ligjit, lidhur me përdorimin e burimeve shtetëore nëpërmjet kontratave publike, investimeve publike, rindërtimit, intimidimit nëpunësve publik, punësimet në administratën publike dhe dhënia e lejeve të legalizimit dhe ndërtimit. Një nga parimet kryesore të procesve zgjedhore në shtetet demokratike është barazia e palëve në garë. Ky parim është sanksionuar në nenin 1 pika 3 të Kushtetutës i cili parashikon se qeverisja bazohet në një system zgjedhjesh të lira dhe të barabarta por një nga sfidat kryesore për të arritur barazinë e partive politike mbetet fakti se partia në pushtet mund të përdorë burimet e shumë fishta që ofron shteti për t'i vënë në funksion të maksimizimit të votës së saj. Me qëllim eliminimin apo reduktimin e këtij rreziku që do të minonte garën nëpërmjet palëve. Shtetet kanë implementuar rregulla të shumta që ndalojnë një sër veprimtarish të qeverisë dhe parlamentit në periudhën përpara zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Shqipëria si vend me probleme të shumta sa i përket zgjedhjeve veçanërisht në vitet e fundit ka vuajtur vazhdimisht shpërdorimin e shfrenuar të burimeve publike nga partia në pushtet me qëllimin e vetëm fitimin e votave nëpërmjet një sërë mekanizmash që ka nën kontroll çdo qeveri gjatë ushtrimit të pushtetit. Për të frenuar përdorimin e burimeve publike dhe më qëllim krijimin e rregullave të barabarta të garës, legjislatori shqiptarë ka miratuar një sërë ndryshimesh në Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të tij që ndalojnë shprehimisht kryerjen e një numri veprimtarish nga ana e qeverisë në periudhën katër muaj përpara zgjedhjeve dhe deri në formimin e qeverisë së re. Veçanërisht ndryshimet e kryera në vitin 2020 në Kodin Zgjedhor u fokusua thuajse tërësisht në adresimin e kësaj problematike, nisur nga përvoja shumë problematike e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017. Konkretisht neni 78 i Kodit Zgjedhor parashikon ndalimin e zhvillimit të fushtës zgjedhore në institucionet publike, më tej ky nen parashikon ndalimin e partive ose kandidatëve për të premtuar vende pune apo favorizime të tjera me qëllim votimin në një mënyrë apo në një mënyrë tjetër të caktuar. Ndërsa neni 91 parashikon ndalimin e vënies në mbështetje të kandidatëve partive, ose koalicioneve të burimeve të organeve apo enteve publike në nivel qendror apo vendor si dhe çdo burimi njerëzor. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet përdorimi i detyruar i administratës shtetërore në zgjedhje ose ofrimi i përfitimeve për nënpunësit që angazhohen në zgjedhje. Pika 3 e këtij neni ndalon marrjen në punë, pushimin, lirimin, lëvizjen dhe transferimin në detyrë përgjatë fushtës zgjedhore. Ndërsa pika 4 parashikon qartësisht ndalimin në periudhën katër muaj përpara zgjedhjeve të nxjerrjes së akteve ligjore nënligjore që parashikojnë dhënie përfitimesh për kategori të caktuara shoqërore. Përcaktimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor sigurisht që ishin të pamjaftueshme për të rregulluar gjithçka që në fakt duhej rregulluar dhe pikërisht u detajuan me vendimin nr. 9 datë 24. 12. 2020 të Komisionit Rregullator

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

të KQZ i cili parashikon shprehimisht se çfarë konsiderohet veprimtari e ndaluar për t'u promovuar, veprimtari të ndaluara në përgjithësi dhe ndalimet e caktuara sa i përket administratës shtetërore. Qartazi qëllimi i këtyre dispozitave ashtu siç ne i kuptojmë ashtu besojmë siç i ka kuptuar edhe legjislatori është të bëjë një ndarje të qartë ndërmjet shtetit dhe partisë në pushtet. Kjo e fundit partia shtet, partia në pushtet nuk duhet të shfrytëzojë pozicionin e saj natyralisht më të favorizuar për të fituar garën ndaj partive të tjera konkurente nëpërmjet mbështetjes me burime shtetërore. Në të kundërt funksionimi si parti shtet do t'a bënte garën elektorale thjesht një formalitet pa asnjë lloj dobie publike. Në rastin e zgjedhjeve parlamentare të 25 Prillit siç kemi shpjeguar gjërësisht në pjesën e rrethanave të çështjes faktuar në 50 prova dhe me qëllim për të shmangur çdo përsëritje të panevojshme. Del qartë në fakt konkluzioni që deklaroi shefja e misionit të vëzhguesve të OSBE/ODIHR zonja Ursula Gaçek se në zgjedhjet e 25 Prillit nuk pati një kufi të qartë ndërmjet partisë dhe shtetit. E thënë me fjalë të tjera Partia Socialiste u soll në fushatën zgjedhore si një parti shtet duke vënë në dispozicion të saj të gjithë mekanizmat shtetëror me qëllimin pastër fitimin e zgjedhjeve me çdo mjet e mundësi të ligjshme apo e paligjshme qoftë ajo. Konkretisht neni 3 i vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ ndalon mbështetjen dhe promovimin në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve të projekteve ose investimeve me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji të energjitikës, të telekomunikacionit, të veprave ujorë të çdo lloji në shërbim dhe në interes të publikut. Megjithatë në të paktën 20 raste të ndryshme që janë konstatuar nga ana jonë dy prej të cilave do i citojmë edhe në këtë rast. Investimet publike u përdorën në Qarkun e Fierit me qëllime të pastra elektorale. Ne kemi cituar një sër rastesh ku u kryen shtrime rrugësh, pa respektuar, pa zbatuar asnjë procedurë prokurimi publik, pa bërë asnjë

Zbardhi materialin audio

Ardita VRIONI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Iloj transparence mbi burimin e këtyre financimeve mbi autoritetin kontraktor apo mbi operatorin ekonomik që i zbatonte këto punime. Promovimi i projekteve apo investimeve publike që do të kryhet në të ardhmen ka për qëllim qartazi në fakt të manipulojë vullnetin e zgjedhësit për të votuar në një mënyrë të caktuar. Këtë mundësi sigurisht nuk e ka asnjë parti opozitare, në këtë kuptim përdorimi i një mekanizmi të tillë nga ana e partisë në pushtet minon shanset e barabarta që kanë synuar të garantojnë legjislacionin zgjedhor për palët që marrin pjesë në një garë elektorale. Megjithëse përmasat reale të kësaj shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor, e cila sigurisht cënon rëndë procesin zgjedhor është e vështirë të përcaktohen në terma matematikor ajo duhet pasur parasysh në momentin e vlerësimit të tërësisë së shkeljeve të ligjit që kanë cënuar procesin në një masë të tillë, sa të ndikojë drejtëpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Së dyti neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe neni 6 i vendimit nr.9 të vitit 2020 përmbajnë rregullime të qarta sa i përket ndalimit të përdorimit apo detyrimit të administratës shtetërore për t'u përfshirë në fushatën zgjedhore në mbështetje të një kandidati apo një partie politike. Megjithatë gjatë gjithë fushatës u konstatuan raste të shumta të denoncuara herë pas here nga PD se si të gjitha nivelet e administratës qendrore apo vendore ishin përfshirë në fushatë në mbështetje të kandidatëve të Partisë Socialiste. Nënpunësit civil ishin nënpresion të vazhdueshëm për të mbështetur kandidatët socialist në të kundërt ata shkarkoheshin nga detyra. Në të paktën 10 raste Partia Demokratike ka faktuar nëpërmjet provave të pakundërshtueshme se Fatos Tushe Kryetari Bashkisë Lushnje, Armando Subashi, Kryetar i Bashkisë Fier dhe Fredi Kokoneshi Kryetar i Bashkisë Divjakë kanë vendosur në dispozicion të kandidatëve për deputet ambjettet e shkollave dhe hapësira të tjera publike për qëllime qartësisht elektorale, nga ana tjetër në një sër rastesh të faktuara dhe kallëzuar nga ana e Partisë Demokratike administrate publike u intimidua dhe kërcënim nga puna nëse nuk

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

angazhoheshin në fushatën e Partisë Socialiste. Mund të veçojmë këtu rastet e presionit ndaj vartësve nga eksponentë me prozicione drejtuese në administratën e Partisë Socialiste si zonja Aurora Peto në funksionin e saj si drejtoresh e shkollës 9 vjeçare Luar, zonja Etilda Disha në Zyrën Vendore Arsimore të Bashkisë Mallakastër dhe zonja Arjana Shani në zyrën vendore arsimore të Bashkisë Lushnje e po ashtu raste të shtetsave të tjerë, të cilët janë cituar nga ana jonë në këtë kërkesë ankimore. E vërteta është se këto shëmbuj janë ilustrime flagrante të shkrirjes në një të vetme të strukturave shtetërore me strukturat partiake. Nënpunësit e administratës lokale dhe qendrore nuk u konsideruan më si nënpunës në shërbim të Shtetit Shqiptarë. Por si ushtarë që duhet t'i shërbenin partisë përndryshe i priste largimi nga puna. Këto shkelje flagrante të legjislacionit penal dhe zgjedhor veçanërisht të dispozitave të sipërcituara cënojnë rëndë procesin zgjedhor pasi garën ndërmjet dy a më shumë subjekteve zgjedhore e kthejnë në fakt në një garë ndërmjet shtetit dhe një partie politike. Është e kuptueshme se një garë e tillë, tërësisht e shpërpjestuar ka një fitues të paracaktuar. Prandaj edhe në këtë rast është e qartë se shkeljet e rënda dhe flagrante të ligjit përkatësisht nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenit nr. 6 të vendimit nr.9 të vitit 2020 të KQZ-së kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor, dëmtuar barazinë e palëve në garën zgjedhore dhe ndikuar drejtëpërdrejtë në rezultatin përfundimtarë të zgjedhjeve në Qarkun e Fierit dhe sigurisht edhe në ndarjen e mandateve në këtë qark. Së treti neni 91 pika 3 e Kodit Zgjedhor dhe neni 3 pika 1/3 germa d e vendimit nr.9 të vitit 2020 ndalojnë punësimet në administratën publike në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve. Megjithatë sipas të dhënave zyrtare të Institutit të Statistikave vetëm në katër mujorin e fundit u punësuan rreth 13 mij njerëz në administratën publike. Qartësisht punësimet në administratën publike në periudhën zgjedhore, kur nuk diktohej nga nevojat e ngutshme kanë për qëllim të përkthehen në mbështetje dhe

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021**

vota për partinë në pushtet cilado qoftë ajo, dhe në këtë rast për partinë Socialiste të Shqipërisë. Se sa është numri i të punësuarve në Qarkun e Fierit, ky është një informacion në fakt duhet të administrohet nga ky komision nëse është vërtet i interesuar për t'a zbardhur masakrën zgjedhore të 25 Prillit deri në fund. Pasi sigurisht burimet e informacionit që ka çdo parti politike shkojnë deri në një masë të kufizuar.

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Shkojnë deri një masë të kufizuar. Së katërti, neni 3 po ashtu i vendimit nr.9 2020, parashikon ndalimin e qartë të veprimtarive publike të cilat konsistojnë në shpërndrjet e lejeve të legalizimit në periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve. Megjithatë, siç kemi reltuar dhe në pjesën e fakteve, Partia Demokratike disponin prova dhe foto të deputetëve të Partisë Socialiste, të cilët në të paktën 12 raste shpërndajnë leje legalizimi në periudhën e ndaluar nga Kodi Zgjedhor me qëllim të pastër elektorale. Ndërsa në 2 raste flagrante të denoncuar në SPAK, dëshmojnë për përmasa reale të këtij problemi. Konkretisht në datat 26, 28, dhe 30 Dhjetor 2020, kandidati për deputet i Partisë Socialiste, shtetasi Bujar Cela ka publikuar në faqen e tij në facebook, raste të shpërndarjes të certifikatave të legalizimit për qytetarët e Qarkut Fier. Raste të tilla janë denoncuar në mënytë të përsëritur nga ana e Partisë Demokratike. është rast flagrant se si në datën 12 Prill 2021, u publikua një audio përgjimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Kadastrës Shtetërore, shtetasit Artan Lame i cili bënte fjalë për rreth 160 mijë leje legalizimi, të cilat do të ndaheshin në 100 mijë kërkesa që do të mbaheshin pezull deri pas zgjedhjeve pasi qytetarëve mund tju refuzohej e drejta për këto leje dhe sigurisht që këto do të ishin vota për partinë kundërshtare. Qytetarët e dinë se tashmë atyre ju kanë shkuar njoftimet nga INKMT për prishjen e banesave dhe bizneseve të tyre sepse zgjedhjet kanë përfunduar. Shumica e këtyre njoftimeve mbajnë datat e muajit Mars 2021, por që është pritur të mbrojnë zgjedhjet për tu lajmëruar. Në fakt 160 mijë leje legalizimi potencialisht kanë të bëjnë me 160 mijë familje, çka dëshmon përmasat e jashtëzakonshme që ka një fenomen i tillë tek ndikimi ose tek vullneti i zgjedhësve i cili u manipulua dhe u tjetërsua në procesin zgjedhor të 25 Prillit. Se sa është numëri i lejeve të legalizimit të shpërndara në Qarkun e Fierit, kjo sigurisht është një e dhënë që duhet të merret nga ky komision për të kuptuar përmasat reale se sa ishte shkelja e ligjit në Qarkun e Fierit. Sepse sado me dëshirën dhe vullnetin

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

mirë të një partie politike cila do qoftë ajo, për të sjellë çdo provë, çdo fakt, çdo indicie, çdo të dhënë, përpara këtij komisioni sigurisht burimet e sajë nuk mundë të jenë të pa shterrshme dhe për të konkluduar për sa i përket kësaj pjese është e qartë se parimi barazisë ndërmjet palëve garuese në zgjedhje u cënua rënde. Pasi shteti dhe partia në pushtet u shkri në një të vetme. Zyrat elektorale të Partisë Socialiste u kthyen në institucione shtetërore ku qytetarë duhet të parqiteshin për tu punësuar, për të marrë leje legalizimi, për të marrë dëmshpërblime nga tërmeti, çelsa apo dokumentat e shpive të rindërtuara etj. Shteti dhe Partia Socialiste në kordinim dhe bashkëpunim me njëra tjetrën i vendosën të gjithë mekanizmat shtetëror në funksion të manipulimit të vullnetit të zgjedhësve në zgjedhjet e 25 Prillit. Projektet dhe investimet publike, punonjësit e administratës, punësime të reja në administratë, lejet e legalizimit, certifikatat e pronësisë u vendosën në fakt në dispozicion të plotë të partisë, të kryeministrit, ministrave dhe deputetëve me qëllim për të fituar me çdo kusht zgjedhjet e 25 Prillit. Këto janë fakte publike të konstatuar në faqet 2, 3 dhe 12 të raportit paraprak të OSBE\ODHIR që besojmë është i njohur edhe për këtë komision. Paligjshmëria e ngritur në sistem nga institucione drejtues institucionesh, zyrtarë të lartë, përfaqësues të pushtetit qëndror dhe vendor dhe në bashkpunim me elementët e krimin të organizuar dikton në çdo shtet dhe shoqëri demokratike, domosdoshmërinë e shpalljes së pavlefshmërisë së këtyre zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre në kushte normale, në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, ku palët do të garojnë në mënyrë të ndershme, të lirë dhe të barabartë, ndërsa qytetarët të zgjedhin me vullnetin e plotë dhe të lirë përfaqësuesi në Kuvendin e Shqipërisë. Sa i përket shkeljeve ligjore lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale të qytetarëve. Neni 35 i Kushtetutës së Shqipërisë, parashikon qartazi se mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth një personi të caktuar bëhet vetëm me pëlqimin e tij, më përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji që

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

rregullon çështjet e të dhënave personale. Neni 8, i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, parashikon se çdo kush ka të drejtën e respektimit tëëjetë së tij familjare banesës dhe koredpindencës së tij. Ndërsa neni 6, i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 për mbrojtjen e të dhënave personale, parshikon se të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i këtyre të dhënave ka dhënë pëlqimin dhe neni 7 përcakton se ndalohet përpunimi i të dhënave personale sensitive, ku përfshihen edhe mendimet apo bindjet politike me përjashtim të rastit kur këtë e kërkon ndonjë interes politik. është fakt publik se të dhënat personale të 910 mijë qytetarëve të Tiranës, ku bëjmë pjesë besoj unë edhe ne që jemi në këtë sallë, të dhënat teje personale si numëri i identitetit, vendëbanimi numëri i telefonit, bindja politike, vendi i punës, u publikuan në media se çdo qytetar çdo person qoftë ai me qëllimë të mira qoftë me qëllime keqëdashëse, me qëllime të ligjshme apo të paligjshme, ka mundësi ti marrë këto të dhëna dhe të njihet me to. Ne kemi cituar në fakt duke besuar se shërbente drejtësisë së vendimit që ju do të merrni në përfundim të këtij procesi, me gjithë mosbesimin tonë një serë vendimesh dhe praktikash edhe të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat flasin veçse për shkelje potenciale ose publikim potencialisht të të dhënave personale. Po këtu nuk jemi përpara një publikimi potencialisht të të dhënave personale. Ky është një fakt që tashmë ka ndodhur, është fakt publik, patronazhistët njëerëz për të cilët as kush unë të paktën nuk kisha ndonjë informacion për patronazhistin tim para se të bëhej publik. Merrnin të dhënat tona personale, i përpunonin, i publikonin, i dërgonin njëri tjetrit e gjitha kjo një veprimtari tërësisht e paligjshme. Në sistem është ngritur paligjshmëria në këtë vend sa kryeministri, kryetari i Partisë Socialste, sekretari i përgjithshëm, drejtues politik i Qarkut të Fierit, nuk ja përtojnë e me karshillik të falenderojnë patronazhistët që vjedhin, përdorin, shpërdorjnë, publikojnë, të dhënat personale të secilit prej nesh. Si qytetarë, por sigurisht dhe si përfaqësues i Partisë

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Demokratike, unë nuk di të këtë dalë deri më sot ndonjë shtetas që ka dhënë miratimin apo pëlqimin e tij që të dhënat personale diku tek disa zyra të errëta të Partisë Socialiste të mblidheshin, të përpunoheshin, e më pas të publikoheshin krejtësisht në mënyrë të paligjshme. Unë mendoj se në çdo shtet është shoqëri Demokratike, për aq sa kam pasur mundësinë ti njoh dhe të udhëtoj. Ky fakt do përbëntë fakt të mjaftueshëm ose shkelje të mjaftueshme për të konkluduar në pavlefshmërinë e këtyre zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre. Pra është e qartë se Partia Socialiste drejtuesit, përfaqësuesit, strukturat, shtabet qendrore, zyrat elektorale morën nga serverat shtetërore të dhënat personale të qytetarëve me qëllim përdorimin e tyre për ti bërë qytetarët më vulnerabël dhe eventualisht për të kontrolluar vullnetin e tyre gjatë fushatës zgjedhore edhe në ditën e votimit. Ky krim i shumëfishtë përbën një rast flagrant se si shteti i vënë në dispozicion të partisë, infrastrukturën e tij për të përfituar zgjedhjet. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i të dhënave personale të qytetarëve, për të cilat askush deri më sot nuk ka dalë të thotë që ka dhënë pëlqimin e tij. Sigurisht përbën një veprimtari krejtësisht të paligjshme që cënon rëndë procesin zgjedhor të 25 Prillit. Sa i përket shkeljeve ligjore lidhur me mohimin e të drejtave për të votuar të emigrantëve shqipëtar, në Greqi në Maqedoninë e Veriut. Kemi pasur mundësi në fakt ta relatojmë dhe ta themi shpesh të drejtën e çdo qytetari që ka për të zgjedhur e për tu zgjedhur. Një e drejtë e garantuar nga neni 45 i Kushtetutës, e garantuar nga neni 3 protokollit 1, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. E garantuar nga një serë vendimesh të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e këtu mund të citonim vendime, praktika të pafundme të cilat sigurisht do të arrinin veçse në konkluzionin që e drejta për të votuar është një e drejtë e cila nuk mund të kufizohet përveçse në raste shprehimisht të përcaktuara, e sigurisht nuk mund të jetë një ndalim kategorik siç ishte vendimi i Komitetit Teknik të Ekspertëve. Por ajo që ka rëndësi e me të cilën

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

ky komision nuk u është marrë për asnjë moment është fakti se dhe në qoftë se nuk përmbushen kushtet apo kriteret e nenit 160 pika 1 të Kodit Zgjedhor lidhur me shkeljet e rënda që kanë ndodhur 1 ose disa qendra votimi, e për mendimin tonë në të gjitha qendrat e votimit në mbarë qarkun e Fierit së paku duhet të ishte marrë me vlerësimin e pikës së dyte të nenit 160 të Kodit Zgjedhor që ka të bëjë me ato raste kur fatkeqësi natyrore të caktuara kanë penguar të drejtën e qytetarëve për të votuar. Pra ose ka pasur një vendimarrje të paligjshme të Komitetit Teknik të Ekspertëve ose ka pasur një vendimarrje e cila është diktuar nga fatkeqësia natyrore e cila në çdo rast referuar nenit 160 të Kodit Zgjedhor i bën zgjedhjet të pavlefshme. Kjo sigurisht mbetet në vlerësimin tuaj për ta marrë parasysh apo për ta analizuar apo për ta trajtuar siç janë trajtuar rastet e tjera por për ne është e qartë se heqja e të drejtës së 500 mijë shtetasve shqiptarë që jetojnë në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut për të votuar në zgjedhjet e 25 Prillit është një shkelje flagrante e Kushtetutës, Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kodit Zgjedhor. Sigurisht kemi shpjeguar gjerësisht se cilat ishin ato që ne i konsiderojmë shkelje ligjore lidhur me pavlefshmërinë e fletëve të votimit dhe diskriminimin që ju bë kandidatëve por jam i bindur që konkluzioni juaj në këtë pikë do ishte përsëri se kjo është një çështje e gjykuar tashmë e për të cilën asgjë nuk mund të bëjmë veçse në qoftë se debati juridik mbase është i mbyllur dhe është fakt publik se një vendim i cili në vlerësimin tonë vjen në kundërshtim me parimet apo kriteret e nenit 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikës 27 të Kodit të Praktikës së mirë që kërkojnë fletë votimi që i mundësonjë orientimin sa më të lehtë të votuesit për të votuar subjektin zgjedhor që ai dëshiron dhe kandidatin e preferuar sollën si pasojë 83028 fletë votimi të pavlefshme në të gjithë Shqipërinë, ose 5% e numrit total të votuesve dhe vetëm në Qarkun e Fierit arritën në 9375 vota. Një numër shumë i konsiderueshëm i cili në vlerësimin tonë absolutisht do kishte ndikuar edhe në ndarjen e mandateve në këtë qark. Sa i përket

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

shklejeve ligjore që kanë ndodhur në lidhje me votimin e dyfishtë votimin për të tretët apo votimin familjar. Sigurisht që futja e elementit të teknologjisë, pra nëpërmjet paisjeve të identifikimit elektronik ishte një kërkesë me insistim, e Partisë Demokratike e cila na mundëson sot të shohim pjesërisht se çfarë ka ndodhur në qendrat e votimit ku ka pasur raste të votimit të shumëfishtë, votimit familjar, votimit për të tretët apo përdorimit të mjeteve të identifikimit të personave të tjerë. Kjo në këtë pikë sigurisht do rezervohet pasi edhe në këtë rast do kërkojmë që nga ana e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve të administrohet në cilësinë e provës marrja e të dhënave të kryqëzuara nga paisjet e identifikimit PEI. Për sa më sipër ne vlerësojmë se në tërësinë e tyre këto shkelje flagrante të ligjit pra shitblerja e votës, përdorimi i personave me precedentë të tmerrshëm kriminal, përdorimi i paligjshëm i administratës publike, vjedhja dhe përdorimi kriminal i të dhënave personale të shtetasve nga Partia Socialiste, përdorimi i paligjshëm masiv dhe sistematik i parave të buxhetit të shtetit për tjetërsimin e vullnetit të qytetarëve dhe përdorimi i lejeve të legalizimit për vota cënuan rëndë procesin zgjedhor duke ndikuar drejtpërdrejt në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore Qarku Fier. Këto shkelje dhe pasojat e tyre mbushin kriteret e kërkuara nga neni 160 dhe neni 161 të Kodit Zgjedhor për shpalljen e pavlefshmërisë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Qarkun e Fierit. Për pjesën e konkluzioneve përfundimtare sigurisht që do rezervohemi për momentin procedural. Faleminderit për vëmendjen.

Z. I. Rusmali: Faleminderit zoti Logu, faleminderit edhe që u treguat i koncentruar në parashtrimin e pretendimeve tuaja. Kursejmë ironinë njëri tjetrit. Jo unë ndoqa me vëmendje dhe unë di me saktësi se sa pjesë nga materiali juaj keni kaluar me ban sens dhe ska asnjë ironi në këtë ka vetëm falenderim që ju i dhatë mundësinë komisionit që atë material që e ka me shkrim ta konsultojë

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

nëpërmjet materialit me shkrim dhe ti lëmë më shumë kohë diskutimit. Kështu që mos e merr për ters gjënë. Ndoshta është momenti tja japim palës së interesuar fjalën pastaj me pyetje? Dakord, përfaqësuesi i partisë Socialiste.

Z. M. Legisi, përfaqësues i PS-së: Po faleminderit i nderuar, të nderuar anëtarë të komisionit ne kërkojmë rrëzimin e kërkesës ankimore me nr.44 subjektit zgjedhor Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim pasi është e pa bazuar në ligj dhe në prova. Neni 160 pika 1 gërma 'a' e vendos apo parashikon pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendër votimi për shkelje të ndodhura në ato qendra votimi. Se çfarë qendra votimi e ka sqaruar mirë Kodi Zgjedhor në nenin 2, të përkufizimeve pika 16 ku thotë që qendër votimi është mjedisi i caktuar për zhvillimin e votimit në përputhje me këtë kod. Po kështu në kreun numër 3, është paracaktuar konstituimi i KQV, detyrat, përbërja, përgjegjësitë, shkarkimet apo lirimet dhe zoti kryetar në asnjë prej shkaqeve të ankimit nuk gjendet lidhja e fakteve të pretenduara apo ngjarjeve se si kanë ndikuar në këto qendra votimi pr kanë një karakter të përgjithshëm. Pë sa më sipër i nderuar kërkojmë rrëzimin e kërkesës faleminderit.

Z. I. Rusmali: Faleminderit juve, përfaqësuesja e LSI?

Znj.S.Caka, përfaqësuese e LSI-së: Po faleminderit, jemi në mbështetje të kërkesës dhe kërkojmë që të pranohet me gjithë objektin e saj, faleminderit.

Z. I. Rusmali: Faleminderit, pyetje nga kolegët? Kam unë, në fakt pyetje që janë shumë shkurt për aq sa më takojnë dhe mund të mbyllem shpejt por ndoshta më vlen që ti sqaroj për pjesën e mëvonshme të shqyrtimit. Zoti Logu, ju keni një grup episodesh të parashtruara në disa kallëzime penale që bëjnë fjalë për zhvillimin e

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

veprimtarive zgjedhore në mjediset e shkollave besoj e keni parasysh kujt po i referohem. Unë desha të pyes për këto raste për këto episode pra për zhvillimin e veprimtarive elektorale në mjediset shkollash ju keni ndjekur rrugën administrative të ankimimit? Domethënë në KQZ?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Zoti Rusmali për çdo shkelje që është konstatuar nga strukturat e Partisë Demokratike janë ndjekur të gjitha mjetet dhe rrugët ligjore qofshin ato në organet administrative dhe në organet gjyqësore.

Z. I. Rusmali: Jo në KQZ, më intereson KQZ keni vënë në lëvizje KQZ-në me ndonjë kërkesë ankimore?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Besoj e morët përgjigjen time çdo shkelje që është konstatuar është referuar në organet ligj zbatuese qoftë ky rasti kur është vlerësuar në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve kur është vlerësuar si shkelje e Kodit Penal është referuar në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm apo të Posaçëm!

Z. I. Rusmali: Dakord, kemi disa.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Zoti Rusmali që po themi mos të kem nevojë të përsëris disa herë përgjigjen time të gjitha përgjigjet e pyetjeve tuaja janë në materialin 71 faqe, të depozituara nga Partia Demokratike dhe në 89 prova të cilat ne ju kemi paraqitur. Për çdo pyetje që do keni do merrni këtë përgjigje në qoftë se doni ta kurseni vetes!

Z. I. Rusmali: Shiko mos u mërzit, mua më duhet..

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Nuk mërzitem aspak zero, zero nuk kam asnjë mërzi!

Z. I. Rusmali: A mbarove tani mua më duhet për procesverbalin e kësaj mbledhje të saktësoj disa gjëra. Unë materialin e kam, materiali është në dosje. Materialin e kam trajtuar me shumë seriozitet, në material mungon përgjigja e kësaj pyetje, prandaj po jua bëj juve. Ju e dhatë përgjigjen atë që doni ju nuk ka asnjë problem mua më mjafton dhe ajo por unë kam disa çështje që duhet ti përsëris për korrektesë procedurale siç është për shembull ju referoheni të 4 kallëzime penale që kanë lidhje me punësimin e kundraligjshëm. Unë desha të pyesja për kallëzimin që ka lidhje me provën nr.63 dhe me provën nr.66. Për këto çështje, për këta episode, e keni ndjekur në rrugë administrative në KQZ çështjen për këto dy prova?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Për çdo shkelje që është konstatuar nga strukturat e Partisë Demokratike, janë ndjekur të gjitha hapat procedural, administrativ dhe gjyqësor që janë vlerësuar nga ana e strukturave tona. Provat i keni në dosjen që ju dispononi!

Z. I. Rusmali: Mua më mungon ky denoncim në dosje!

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

Z. I. Rusmali: Mua më mungon ky denoncim në dosje.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kur kemi vlerësuar se ka elemente të veprës penale, ne i jemi drejtuar prokurorisë.

Z. I. Rusmali: Dakord! Në qoftë se mungon ankimimi administrativ do të thotë se keni preferuar ankimin penal, rrugën penale. T'a bëj edhe një pyetje tjetër?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Është e drejta e palës!

Z. I. Rusmali: Patjetër, patjetër! Nuk është vërejtje! Është pyetje pasi dua të kuptoj! Prova nr. 37. Edhe në provën 37 ju keni bërë një ankim kundër kryetarit të bashkisë Fier. Që unë t'ua kujtoj se mbase, ... dakord! E dini se për çfarë bëhet fjalë. Për këtë rast, për episodin të cilit i referohet prova nr. 37, a keni vënë në lëvizje KQZ-në nëpërmjet procedurave administrative?! Në dosje më mungon një element i tillë!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Zoti Rusmali, prova nr. 37, të cilës i referoheni ju ka të bëjë me faktin që kryetarët e bashkive socialiste, të 60 Bashkive, kanë refuzuar, që në përputhje me detyrimet e tyre që vijnë nga kodi zgjedhor dhe nga udhëzimi nr. 6/2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të publikojnë cilat janë vendet ku lejohet afishimi i materialeve propagandistike. Ndërkohë, kjo për partinë Demokratikë, pasi partia Socialiste i afishonte materialet e saj propagandistike në muret e Bashkive. Në dijeninë time nga strukturat e partisë Demokratike, është vlerësuar se këto përbëjnë shkelje flagrante të ligjit, të natyrës edhe penale dhe për

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

këtë arsye janë depozituar 60 kallëzime penale, për 60 drejtuesit e bashkive të partisë socialiste.

Z. I. Rusmali: Ne, 59 nuk na interesojnë! Ne na intereson njeri; sepse, ky është duke u shqyrtuar.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Mua më interesojnë 60 i nderuar! Juve ju intereson vetëm njeri.

Z. I. Rusmali: Çështjes këtu i intereson vetëm Fieri.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Jo, nuk është vetëm Fieri! Ka disa bashki Qarku Fier dhe për secilën prej tyre kemi depozituar kallëzim.

Z. I. Rusmali: Në kallëzimet penale është vetëm kryetari i Bashkisë Fier. Dhe prandaj bëhet pyetja për të saktësuar këtë gjë.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: E morët përgjigjen besoj!

Z. I. Rusmali: Faleminderit për përgjigjen; është shumë shpjeguese. Dhe një pyetje të fundit që ka lidhje me vendimet që ju keni cituar në të gjithë kërkesat tuaja ankimore. Me vendimin e qeverisë që ka dalë në këtë harkun kohor të katër mujorit, dhe që ndalohet sipas pikës 4 të nenit 91, për këto vendime që ju i konsideroni në kundërshtim me ligjin, keni ndjekur rrugën administrative pranë KQZ-së?!

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Në dijeninë time më të mirë, i nderuar, strukturat e Partisë Demokratike, për çdo shkelje të ligjit kanë informuar organet ligj zbatuese, qoftë KQZ-në, por edhe në ato raste kur janë vlerësuar, se këto përbëjnë shkelje të karakterit penal, rastet janë referuar pranë prokurorisë. Sepse, po ju jap edhe përgjigjën cila ka qenë arsyeja e kësaj zgjedhje, kemi parë, kemi konstatuar, dhe mund t'iu sjell edhe një rast konkret të kryetarit të Bashkisë Librazhdit, se pavarësisht,

Z. I. Rusmali: Nuk më hyn në punë Librazhdi!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Jo, jo, ndjesë! Ka rëndësi sepse ne kemi zgjedhur rrugën për të shpjeguar mirë si kemi vepruar! Se, kemi parë se pavarësisht se, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nxirrte vendime, udhëzime, edhe sanksione administrative, vinin këtu tek ju, anuloheshin dhe kjo bëhej një mjet jo efektiv! Kështu që duke qenë se kjo ishte një mjet jo efektiv, kemi vendosur që të kryheshin hetime penale.

Z. I. Rusmali: Librazhdi jo! Po pra, do të thotë ne kemi rrezuar kryetarin e bashkisë së Librazhdit dhe ka ngelur në fuqi gjoba, apo jo!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Nëse keni interes, jua shpjegoj unë!

Z. I. Rusmali: Jo, jo, s'ka gjë e mora shpjegimin nga kolegët!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Është e rëndësishme!

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

Z. I. Rusmali: E mora shpjegimin nga kolegët!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: A mundem t'a, ...!

Z. I. Rusmali: Jo, jo, do të shoh a kam pyetje tjetër dhe me pas do të pyes kolegët a kanë pyetje edhe ata! Mirë! Keni pyetje të nderuar kolegë?! Nuk ka pyetje! Atëherë sipas procedurës na takon tek prezantimi i provave. Duhet të kalojmë tek prezantimi i provave! Fjalën e ka zoti Logu!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit i nderuar kryesues i seancës! Pra, rasti i Librazhdit ishte një rast flagrant ku në murin e bashkisë kishte një postër të Partisë Socialiste ...

Z. I. Rusmali: Jemi në dijeni! Jemi në dijeni!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Që t'ua rikujtoj!

Z. I. Rusmali: Jemi në dijeni! Ne jemi në dijeni të kësaj gjëje! Të lutem shumë bëj prezantimin e provave!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Atëherë, në faqen 68, 69, 70 dhe 71 të kërkesës ankimore të paraqitur nga Partia Demokratike, për pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në qarkun Fier, Partia Demokratike ka cituar 89 prova të depozituara tashmë! Unë po i lexoj provë për provë! Cilat janë provat që Partia Demokratike ju ka vënë në dispozicion, ... Jo, është e drejta ime do ta zgjedh unë, ...

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

Z. I. Rusmali: Ndoshta mund ta shfrytëzonim kohën për të sqaruar disa probleme me këto prova!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Dakord, por unë do t'a shfrytëzoj kohën për të lexuar secilën nga këto prova sepse mendoj se janë të rëndësishme secila në vetvete!

Z. I. Rusmali: Dakord! Një nga një!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Prova numër një! Material i marrë nga burime mediatike për denoncimin e bërë nga Partia Demokratike; Material nga media për shtetasin Renato Cani; Prova nr. 3, ekstrakt i shoqërisë AGA 1 sh.p.k.; prova nr. 4 të dhëna nga Open Procurement, për këtë shoqëri; prova nr. 5, të dhëna nga Open Procurement, për tenderin që ka zhvilluar kjo shoqëri me bashkinë Fier; prova nr. 6, ekstrakti i shoqërisë Vesa 2015, sh.p.k.; prova nr. 7, kallëzimet penale në SPAK, nga ana e Partisë Demokratike të datës 4.02.2021, për shkelje në qarkun Fier, ...

Z. I. Rusmali: Të lutem ndalojmë tek prova nr. 7 se kam nevojë për një pyetje këtu! Ju flisni për kallëzime penale në SPAK; prova nr. 7 i referohet një grupi kallëzimesh apo një kallëzimi?!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ne, i nderuar në SPAK, për shkeljet që kanë ndodhur në qarkun e Fierit kemi depozituar 2 kallëzime penale!

Z. I. Rusmali: Në fakt keni depozituar 5! Dhe janë, ...

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kjo provë që ju citova këtu, dhe që është e të njëjtës datë, janë dy kallëzime penale! Të cilat po i referojmë edhe me materialet dhe ja ku i keni!

Z. I. Rusmali: Në listën tuaj, kallëzimi penal mban datën 4.02.2021, në fakt është 2.04.2021! Dhe është një kallëzim!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Tani besoj se një material kaq voluminoz, është e pranueshme që mund të ketë edhe lapsuse!

Z. I. Rusmajli: Jo, por duam t'a saktësojmë, ... nuk ka asnjë problem!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Tani nëse doni të merreni me lapsuse! Patjetër,
...

Z. I. Rusmali: Jo, vetëm duam ta saktësojmë, ... nuk ka asnjë problem! Dua të dimë të dy palët që flasim për të njëjtën gjë!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Patjetër! Prova nr. 8

Z. I. Rusmali: Jo, të lutem, bëhet fjalë për një kallëzim, apo jo?! Dhe është ky që thamë bashkë!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Tani edhe njëherë i nderuar, më fal që, ... prova nr. 7 citohet në faqen 4, dhe ka të bëjë pra me dy kallëzime penale, të njëjtës datë me të cilin janë kallëzuar shtetasit, Petrit Rama, Fredi Kokoneshi etj., etj.,

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

fillimisht, për disa vepra penale të cilat janë të cituara në faqen 4, dhe më pas bëhet fjalë për një kallëzim tjetër penal, ku janë kallëzuar shtetasit Rajmonda Balili, Nimet Musai, Antoneta Dhima e kështu më rradhë etj., etj.

Z. I. Rusmali: Dakord! Kallëzimin e dytë duhet t'a depozitoni sepse se keni...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Janë dy kallëzime! Ndoshta për shkak të volumit, ...! Po sigurisht që jemi të gatshëm ta depozitojmë në kohën më të afërt që të na jepni mundësinë! Duke qenë se materialet ishin voluminoze në fakt kjo ishte edhe baza e arsyeshme e kërkesës sime.

Z. I. Rusmali: Dakord! Kalojmë tek prova 8! Mbani shënim ju lutem që kallëzimin e dytë penal t'a depozitoni! Kaq është puna!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Prova nr. 8, kallëzim penal i datës 17 prill 2021 për shtetasin Fredi Kokoneshi, etj, nëse doni mund ti citojmë të gjithë shtetasit, ...

Z. I. Rusmali: Jo, s'ka nevojë!,

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Prova nr. 9 kallëzim penal i datës 24 mars 2021 për shtetasin Novruz Shehu. Prova nr. 10 kallëzim penal i datës 1 prill 2021, shtetasit Petrit Rama e të tjerë

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

Z. I. Rusmali: Tek prova nr. 10 duhet të ndalemi sepse kjo mungon në dosje! Ose është e njëjta me provën nr. 7, sepse nga emrat rezulton e njëjta! Ose është një provë që mungon në dosje.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Dakord! Në dijeninë time është depozituar bashkë me provat e tjera që ne kemi vënë në dispozicion, por ne do t'a mbajmë shënim dhe do tua vëmë në dispozicion sa më parë.

Z. I. Rusmali: Dakord!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Të ndjekim këtë logjikë për të gjitha provat, që të mos ndalemi se humbasim kohë, ...

Z. I. Rusmali: Do të ndalemi tek secila që ka nevojë për saktësim!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Dakord! Por kallëzimi është i saktësuar domethënë, kush janë shtetasit, çfarë kanë bërë e kështu me radhë, pastaj informacione të mëtejshme, ...

Z. I. Rusmali: Ne, na mungon prova!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Prova nr. 11, kallëzimi penal i datës 24 Mars 2021, për shtetasin Bardhyl Kapaj; Prova nr. 12, kallëzimi penal i datës 31 Mars 2021, për shtetasin Dilaver ...

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

Z. I. Rusmali: Edhe këtu duhet të ndalem pak! Kallëzimi penal është i datës 3.04.2021; në qoftë se nuk është i datës 3.04.2021, atëherë mungon kallëzimi penal.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Atëherë në faqen 7, keni në datën 31 mars 2021, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasve Dilaver Shyti, Arben Voja, Gezim Dhima, Arjan Fasko, etj., etj.,

Z. I. Rusmali: Të gjithë emrat i kam këtu, kallëzimi penal mban datën 3.04.2021!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Data është 31 Mars 2021. Në qoftë se ka ndodhur një mos akordim datash, jemi të gatshëm që t'a korrigjojmë!

Z. I. Rusmajli: Jo, duhet vetëm të më thoni është i njëjti dokument apo janë dy dokumente të ndryshme!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ne, i nderuar, kemi një kallëzim të bërë në datën 31 mars 2021, prova nr. 12 që është ...

Z. I. Rusmali: Kallëzimi penal mban datën tjetër! Duhet të më thoni është i njëjti apo jo vetëm kaq!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kini parasysh edhe faktin që ka kallëzime penale ku ka emra të të njëjtëve shtetas dhe mbase edhe ju gaboheni në këtë pikë! Por gjithsesi,

Z. I. Rusmali: Unë ...!

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Jo, ndjesë, ...

Z. I. Rusmali: Në qoftë se ekziston kallëzimi me datë 31 mars 2021, nuk gaboju unë; mungon në dosje! Dhe duhet plotësuar! Në qoftë se kallëzimi është, por është ai me datë 3 prill, atëherë jemi në rregull, vetëm do të korrigjojmë datën. O njëra o tjetra! Nuk është çështje gabimi i imi apo i juaji. Është çështje saktësie dokumentare.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ka një kallëzim penal të datës 31 Mars, ku, nëse ka ndodhur një lapsus që nuk është në dosje, do t'ua vendosim në dispozicion.

Z. I. Rusmali: Dakord! Duhet ta saktësoni! Faleminderit!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Prova nr. 13, kallëzimi penal i datës 24 Mars 2021, për shtetasit Moza Celibashi etj., kemi disa shtetas, nëse ka nevojë mund ti citoj?! Prova nr. 14, kallëzimi penal i datës 27 mars 2021, për shtetasin Mariol Sina; Prova nr. 15, kallëzimi penal i datës 18 mars 2021, për shtetasit Zhaklin Nurçe etj., Prova nr. 16, kallëzimi penal i datës 19 mars 2021, për shtetasi Zhezmi Zulali; Prova nr. 17, kallëzimi penal i datës 24 mars 2021, për shtetasit Kristina Gobere, etj.; Prova nr. 18, kallëzimi penal i datës 13 prill 2021, për shtetasin Fredi Kokoneshi; Prova nr. 19, kallëzimi penal i datës 18 mars 2021, për shtetasin Avni Salla, etj.; Prova nr. 20, kallëzimi penal i datës 1 prill 2021, për shtetasin Sadush Bali, etj; Prova nr. 21, kallëzimi penal i datës 18 mars 2021, për shtetasin Ardit Janko etj.; Prova nr. 22, kallëzimi penal i datës 16 prill 2021, për shtetasin Baftjar Zeqaj; Prova nr. 23, kallëzimi penal i datës 23 prill 2021, për shtetasin Arjan

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

Faskaj, etj; Prova nr. 24, kallëzimi penal i datës 20 mars 2021, për shtetasit Armando Subashi, etj.; Prova nr. 25, kallëzimi penal i datës 18 prill 2021, për shtetasit Fatos Tushe, etj.; Prova nr. 26, foto nga faqja e facebook e shtetases Antoneta Dhima; prova nr. 27, 28, 29 kanë të bëjnë me vendime të Këshillit të Ministrave; prova nr. 30 është një ankesë pranë shërbimit për çështjet e brendshme, pranë Ministrinë për Punët e Brendshme për shtetasin Altin Shehu, shef i komisarariatit të policisë në Bashkinë Divjakë dhe të tjerë shtetas të përfshirë; Prova nr. 31, kallëzimi penal i datës 10 prill 2021, për shtetasin Fredi Kokoneshi; kallëzimi penal i datës 13 prill 2021, për shtetasin Fredi Kokoneshi; kallëzimi penal i datës 17 prill 2021, për shtetasin Fredi Kokoneshi; po ashtu tjetër kallëzim penal i datës 17 prill 2021, për shtetasin Fredi Kokoneshi; prova nr. 35, kallëzimi penal i datës 23 prill 2021, për shtetasin Erjon Braçe; prova nr. 36, kallëzimi penal i datës 14 prill 2021, për shtetasin Altin Shehu; prova nr. 37, kallëzimi penal i datës 14 prill 2021, për shtetasin Armando Subashi; prova nr. 38, kallëzimi penal i datës 31 mars 2021, për shtetasin Armando Subashi; prova nr. 39, kallëzimi penal i datës 5 prill 2021, për shtetasin Gramoz Ruçi; prova nr. 40, kallëzimi penal i datës 9 prill 2021, për shtetasin Armando Subashi; prova nr. 41, kallëzimi penal i datës 17 prill 2021, për shtetasin Arjan Hasani;

Z. I. Rusmali: Tek kjo duhet të ndalemi pak!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Patjetër!

Z. I. Rusmali: Ju keni kallëzimin penal të datës 17 Mars 2021. Ose është gabim data ose na mungon kjo provë!

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Për Arjan Hasanin!

Z. I. Rusmali: Po!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Mund të ketë ndodhur një lapsus!

Z. I. Rusmali: Dakord! Mbajeni shënim ju lutem!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po, patjetër!

Z. I. Rusmali: Apo ta konsiderojmë si të mirëqenë?!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Shikoni i nderuar! Për secilin prej këtyre në fund, mendoj të bëjmë një akordim, ... për ata që mungojnë, ...!

Z. I. Rusmali: Jo, akordimi është ky që po bëjmë!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Dakord, pra duhet ti mbajmë edhe shënim se jemi në kushtet kur, ...

Z. I. Rusmali: Mund ti mbani shënim, kemi kohë; pa problem!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Dakord

Z. I. Rusmali: Ta konsiderojmë të mirëqenë apo, ...?!

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Nëse është për të njëjtin shtetas?!

Z. I. Rusmali: Është për të njëjtin shtetas?! Ndryshon muaji! Ta marrim të mirëqenë?!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Dakord, është e mirëqenë sepse është përsëri kallëzim për këtë shtetas!

Z. I. Rusmali: Vazhdojmë!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Dakord

Z. I. Rusmali: Mund ti mbani shënim, kemi kohë; pa problem!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Dakord

Z. I. Rusmali: T'a konsiderojmë të mirëqenë apo, ...?!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Nëse është për të njëjtin shtetas?!

Z. I. Rusmali: Është për të njëjtin shtetas. Mund ti mbani shënim, kemi kohë; pa problem!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Dakord

Z. I. Rusmali: Ta konsiderojmë të mirëqenë apo, ...?!

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Nëse është për të njëjtin shtetas?!

Z. I. Rusmali:: Është për të njëjtin shtetas! Vetëm se ndryshon muaj!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Është e mirëqenë sepse është bërë kallëzim për këtë shtetas!

Z. I. Rusmali:: Dakord! Vazhdojmë!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Prova nr. 42, kallëzimi penal i datës 12 prill 2021, për punonjësit e OSHEE Lushnjë; Prova nr. 43, kallëzimi penal i datës 19 prill 2021, për shtetasin Fatos Tushe; 19 prill; 11 prill; 27mars; 5 prill; 1 prill 2021 deri tek prova 48 janë kallëzime penale për shtetasin Fatos Tushe, kryetar i bashkisë, Lushnjë; prova nr. 49, kallëzim penal i datës 18 Mars 2021, për shtetasin Dashmir Ndreka; prova nr. 50, kallëzim penal i datës 18 Mars 2021, për shtetasin Arben Myrto; prova nr. 51, kallëzim penal i datës 9 Mars 2021, për shtetasin Pjerin Vogli; prova nr. 52, kallëzim penal i datës 19 Mars 2021, për shtetasen Arjana Shani; prova nr. 53, kallëzim penal i datës 10 prill 2021, për shtetasin Fatos Tushe; prova nr. 54, kallëzim penal i datës 11 Mars 2021, po ashtu, për shtetasin Fatos Tushe, etj.; prova nr. 55, kallëzim penal i datës 13 prill 2021, për shtetasin Qerim Ismailja, dhe ka dhe një kallëzim tjetër të datës 1 prill 2021; kallëzim penal të datës 17 mars për shtetasen Etilda Dishaj; për shtetasen Aurora Pepaj në të njëjtën datë; prova nr. 59, kallëzim penal të datës 18 mars 2021 për shtetasen Majlinda Bufi, Kryetare e Bashkisë Roskovec; prova nr. 60, të dhënat e INSTAT për numrin e të punësuarve në institucionet shtetërorë e publike për tremujorin e tretë dhe të katërt

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

të vitit 2020; raporti paraprak i OSBE-ODIHR; kallëzimet penale të datës 30 Mars 2021, ...

Z. I. Rusmali: Më fal, kjo është pyetje nuk ka asgjë tjetër! Asaj që ju i referoheni si prova nr. 60, bëhet fjalë për një të dhënë nga media, për të dhënat e INSTAT-it apo, është e dhënë zyrtare e INSTAT-it?!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Është një raportim mediatik!

Z. I. Rusmali: Dakord!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Por i besuar sepse është shpërndarë nga të gjitha mediet!

Z. I. Rusmali: Ecim me tutje!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kallëzim penal i datës 30 mars 2021 për shtetasin Arjan Faskaj! Kallëzim penal i datës 17 mars 2021; prova nr. 64, kallëzim penal i datës 24 mars 2021, për shtetasit Petrit Kanani etj.; kallëzim penal i datës 17 prill 2021 për shtetasin Arjan Faskaj!

Z. I. Rusmali: Data e këtij kallëzimi penal, prova nr. 65, është sipas kallëzimit penal, është data 17.03.2021! është mars. Jemi dakord me marsin?!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Dakord! Mund të ketë ndodhur që në tërësinë e provave, ...

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.05.2021*

Z. I. Rusmali: Pa problem!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kallëzim penal i datës 18 mars për shtetasen Majlinda Bufi; kallëzim penal i datës 19 prill për shtetasen Altin Shehu; prapë për shtetasin altin Shehu; në 10 prill për Fredi Kokoneshin;

Z. I. Rusmali: Një sekondë të lutem! Prova nr. 69, mua me rezulton jo kallëzim penal, por, me rezulton ankim tek shërbimi i brendshëm për ankesa!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Është e saktë nderuar, është laspsus nga ana jonë!

Z. I. Rusmali: Dakord!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kallëzim penal i datës 13 prill; 17 prill; janë për shtetasin Fredi Kokoneshi, dhe të tjerë shtetas; prova nr. 73, kallëzim penal i datës 17 prill 2021, për shtetasin Feriz Stambolliu; prova nr. 74, kallëzim penal i datës 14 prill 2021, për shtetasin Fredo Kokoneshin dhe të tjerë, me të cilët ka vepruar në bashkëpunim; prova nr. 75, është po ashtu kallëzim penal për shtetasin Ardit Gjocaj dhe të tjerë; prova nr. 76, kallëzim penal i datës 23 prill 2021, për shtetasin Shpëtim Gremi dhe të tjerë; prova nr. 77 ka të bëjë me një artikull të publikuar në media për listën me 910 mijë qytetarë të Tiranës, të dhënat e të cilëve ishin marrë dhe përdorshin nga strukturat e shtabet elektorale të partisë socialiste; prova nr. 78 ka të bëjë me një artikull mediatik i cili flet se databaza e të dhënave personale, në strukturat e Partisë Socialiste, ekzistonte në të gjitha qarqet e Shqipërisë.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Prova nr.79 është një denoncim i kryetares së Lëvizjes Socialiste për Integrim, e cila në fakt ka të bëjë me Qarkun e Durrësit, por në vlerësimin tonë shërben si referencë, për të kuptuar se kjo ishte një skemë e shpërndarë masivisht në të gjitha qarqet e Shqipërisë.

Z.I.Rusmali: A mundet të të ndërpres? Ju mungon edhe prova nr.76 në dosje.

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Dakord! Do mbahet shënim dhe do jua vëmë në dispozicion. Prova nr.79, denoncimi i zonjës Kryemadhi për të dhënat personale, e thamë, prova nr.80, publikim në media, me videon për falenderimin e patronazhistëve, nga kryetari i Partisë Socialiste. Pra, ka disa prova, edhe prova nr.81, që ka të bëjë pikërisht me fenomenin e patronazhistëve, ndërkohë që prova nr.82 ka të bëjë me urdhrin e Komitetit Teknik të Ekspertëve, për karantinimin e personave që vijnë nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut, e cila në vlerësimin tonë është një vendim që iu mohoi në mënyrë kategorike të drejtën, 500 mijë shtetasve shqiptarë, me të drejtë vote, për të votuar. Kemi nga prova nr.83 deri në provën nr.86, është praktika që është ndjekur me formatin e fletës së votimit, që mendoj është e njohur edhe për këtë Komision. Prova nr.87 ka të bëjë me një informacion, përsa i përket fletëve të votimit të pavlefshme, të publikuara në faqen zyrtare të KQZ-së. Prova nr.88 ka të bëjë me deklaratën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në datë 28.04.2021, përsa i përket fletëve të votimit të pavlefshme dhe prova nr.89, dhe prova e fundit që ne kemi vënë në dispozicion të këtij Komisioni, ka të bëjë në fakt, me audio-përgjimin e drejtorit të Përgjithshëm të Kadastrës Shtetërore, Artan Lame, që i referohet artikullit mediatik, ku ai është publikuar.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Z.I.Rusmali: Në rregull! Në qoftë se i konsiderojmë të mirëqena çështjet e diskordancave të datave, unë po bëj një përmbledhje. Ju keni, domethënë çështjen e penaleve, jo këtyre vendimeve, e me radhë. Ju keni 2 prova që kanë lidhje me Shërbimin e Çështjeve të Brendshme. Keni 5 kallëzime penale drejtuar SPAK-ut, keni 33 kallëzime penale drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe keni 23 kallëzime penale drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier. Ju mungon prova 10 dhe 76 dhe nga ajo që më është dhënë mua, keni 9 kallëzime penale tepër, të preferuara në listën tuaj. Gjithsej janë 9, 1 për SPAK-un, 6 për Prokurorinë e Fierit, 1 për Lushnjen dhe 1 ankim besoj, për Shërbimin e Çështjeve të Brendshme. Por, këto nuk janë në listën tuaj të provave, i kam unë, por nuk i ka KQZ-ja, kështu që, kjo është një gjë që, juve thatë një shifër tjetër, ju thatë që keni depozituar 74 ose 75 kallëzime penale? Se mbaj mend shifrën prandaj po ju pyes?

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Në dijeninë tonë i nderuar, janë depozituar 74 kallëzime penale, kallëzime penale që kanë të bëjnë me SPAK-un, ashtu dhe kallëzime penale që kanë të bëjnë me Prokurorinë e Përgjithshme.

Z.I.Rusmali: Por nuk i keni këtu 74 kallëzime!

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Mund të ndodhë, ju thashë edhe njëherë domethënë, që për shkak të materialit...

Z.I.Rusmali: Që të kuptohemi, nuk kam asnjë...

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Po ju jap një shpjegim, në qoftë se më lejoni të bëj edhe unë shpjegimin tim. Mund të ndodhë thashë, pra nuk po ju mohoj asgjë,

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

sepse jemi këtu, duhet të kisha dosjen e provave këtu me vete dhe pastaj të bënim një diskutim të tillë dhe ju kërkova kohë, por për shkak, të mos t'i rikthehem asaj që nuk u pranua.

Z.I.Rusmali: S'ka gjë, e kam unë, rri pa merak!

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Por, çdo diskordancë që ekziston po themi, ndërmjet citimeve apo numrit, e kështu me radhë, është një gjë që është lehtësisht e zgjidhshme. Sot, që sot pasdite, me administratën e Komisionit Qendor të Zgjedhjeve, mund ta rregullojmë dhe mund ta paraqesim pranë këtij Komisioni, ato që kemi dashur të provojmë me kallëzimet penale, besoj u relatua dhe u parashtrua gjerësisht në fjalën time, përse i përket parashtrimeve.

Z.I.Rusmali: Por gjithsesi, do i rrimë listës që ju i keni bashkëlidhur kërkesës!

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Sigurisht që do i qëndrojmë listës.

Z.I.Rusmali: Atëherë saktësojmë për këto dy, tri gjëra që kanë dhe pastaj jemi të gjithë të qetë. Gjë tjetër për provat që keni?

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Për provat që kemi i nderuar, këto prova që ne kemi cituar, kërkojmë të administrohen nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në cilësi të provës.

Z.I.Rusmali: Faleminderit! Palët e interesuara kanë gjë në lidhje me këtë çështje, me provat që janë bashkëlidhur?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Z.M.Legisi, përfaqësues i PS-së: Jo, nuk kemi!

Z.I.Rusmali: Nuk keni gjë, as ju? Kolegët kanë gjë për këtë? Jo!

Z.L.Braho: Kisha një pyetje! Nga fjala juaj që thatë, janë diku tek 8, 9 kallëzime që nuk janë në listën e provave?

Z.I.Rusmali: Nuk janë fare!

Z.L.Braho: Tani në qoftë se kallëzimet nuk janë në listë, unë them që dhe ato duhen pranuar si prova.

Z.I.Rusmali: Është çështje e palës, nuk është çështje e jona.

Z.L.Braho: Gjithsesi zoti Logu t'i qartësojë të gjitha këto, në qoftë se janë.

Z.I.Rusmali: Domethënë, ajo që është, është lista, zoti Logu ra dakord t'i rrijë listës, por asgjë nuk e pengon që ta modifikojë listën, vetëm se duhet ta bëjë proceduralisht këtë gjë. Unë saktësova që të listës janë këto që thashë dhe mungojnë 2, domethënë janë ende të paplota.

Z.L.Braho: Zoti Logu, sqaroje listën, pra të plotësohen ato që mungojnë nga lista, që janë këto të dyja, ose plotësim ose korrigjim të dhënash dhe në lidhje me këto 8, 9 që janë mbi listën, ose të shtohet lista ose të hiqni dorë nga ato, t'i tërhiqni si prova. Pra kjo është zgjidhja.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Shiko, zoti Braho domethënë, lista përmban 89 prova. Provat, siç besoj mund ta ketë konstatuar dhe Komisioni lehtësisht, janë në çdo paragraf ku ne referojmë, po themi, një të dhënë konkrete.

Z.I.Rusmali: E qartë, e qartë! Unë i kam kontrolluar!

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Është i rëndësishëm ky shpjegim që do bëj, në qoftë se ne nuk i kemi relatuar ato prova, por ngaqë ndoshta ne, dokumentacioni ka qenë në një volum të caktuar, janë depozituar bashkë me to, është sepse ne nuk kemi vlerësuar që i shërbejnë këtij shqyrtimi administrativ. Kështu që ato që nuk janë cituar në listën tonë të provave, nuk duhet të merren në konsideratë nga ana e këtij Komisioni, por të na kthehen mbrapsht sepse janë dokumentacione që na shërbejnë ne.

Z.I.Rusmali: Por, fotokopje ishin.


Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Nuk ka nevojë që të ngelen në dosjen tuaj!

Z.I.Rusmali: T'i jap tani se i kam.

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Tani ose më vonë s'ka rëndësi, kurdo që t'i keni zoti Rusmali.

Z.I.Rusmali: Mirë, dakord!

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Ndërkohë që ato prova që mungojnë do t'jua vëmë në dispozicion.

Z.I.Rusmali: E sqaruar këtë pikë. Pyetje, nuk ka nga kolegët? Kalojmë tek kërkimi i provave, zoti Logu!

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti kryesues i seancës! Përsa i përket provave që në fakt ne kërkojmë që të administrohen, bazuar në nenin 137, pika 1, të Kodit Zgjedhor, i cili detyron, parashikon detyrimin, që kanë organet e administratës publike, për t'i vënë në dispozicion këtij Komisioni, informacione, dokumente apo çdo provë tjetër që kërkohet ose çmohet i nevojshëm, për kërkimin administrativ, në faqen 62, 63 dhe 64 ne e kemi bërë citimin, provë për provë të atyre që ne kërkojmë të merren gjatë këtij hetimi administrativ. Zoti Rusmali, ndjesë sepse ndoshta u harrua pak më përpara, jo në cilësinë e provës, por për të treguar që ne i kemi ezauruar, po themi, kërkesat tona, ashtu siç bëmë dhe në proceset e tjera, ne do të kërkojmë që të depozitojmë një kopje të kërkesës që ne kemi depozituar.

Z.I.Rusmali: Ajo është e mirëqenë për ne edhe sikur ta harroni, ta konsideroni që e keni thënë këtë, kështu që pa merak!

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Ideja është që ne na intereson, të themi edhe për këtë proces, por edhe për procese të mëtejshme, kështu që është e rëndësishme për mua që të mbahet në shqyrtim, që e kemi kërkuar. Në qoftë se vlerësohet nga ana juaj e nevojshme, unë edhe po i citoj të gjitha provat që ne kemi kërkuar. Janë në fakt në numër, kemi kërkuar 18 prova në këtë rast sepse ka prova, të cilat nuk ishin relevante për Qarkun e Fierit dhe një nga këto prova, prova me nr.18, që ne

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

kërkojmë të administrohet nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, ka të bëjë dhe me marrjen e të dhënave, të kryqëzuara ndërmjet pajisjeve të identifikimit elektronik PEI, për zonën zgjedhore, Qarku i Fierit.

Provat që ne kemi kërkuar janë konkretisht:

marrjen e një informacioni zyrtar nga Prokuria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar për numrin e procedimeve penale lidhur me krimet zgjedhore të kryera në Qarkun Fier dhe fazën e tyre;

marrjen e një informacioni zyrtar nga Prokuroria e Përgjithshme për numrin e procedimeve penale lidhur me krimet zgjedhore në gjithë prokuroritë brenda Qarkut Fier, në fazën në të cilën ato ndodhen;

marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për numrin e shtetasve të ndaluar, të arrestuar dhe numrin e rasteve të referuara për krime zgjedhore në Qarkun Fier;

marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, mbi gjendjen e rezervave të shtetit në depozitat qendrore dhe lokale, për çdo muaj, nga periudha dhjetor 2020 – maj 2021;

marrjen e një informacioni zyrtar nga Inspektoriati Qendror dhe i të gjitha inspektoriateve që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, brenda Qarkut të Fierit, për numrin e inspektimeve të kryera në periudhën 24 dhjetor 2020 - 01 maj 2021, për numrin e gjobave dhe sanksioneve të vendosura, numrin e sanksioneve, gjobave të revokuara me vendim administrativ ose vendim gjyqësor;

marrjen e një informacioni zyrtar nga Agjencia e Prokurimeve Publike, për numrin e tenderave, koncesioneve, PPP-ve të shpallura rishtazi, apo për të cilët janë shpallur fituesit në periudhën 24 dhjetor-1 maj 2021, për projektet brenda Qarkut të Fierit;

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.27.05.2021

marrjen e një informacioni zyrtar nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe 61 bashkitë e vendit, për numrin e lejeve të ndërtimit, të dhëna në periudhën 24 dhjetor 2020 - 01 maj 2021 në Qarkun Fier, saktësim për bashkitë që ndodhen në Qarkun Fier;

marrjen e një informacioni zyrtar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për numrin e lejeve të legalizimit, të dhëna sipas qarqeve në periudhën 24 dhjetor 2020 - 01 maj 2021;

marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, mbi numrin e shtetasve shqiptarë, që ndryshuan adresat e banimit në periudhën 01 janar 2020 – 01 maj 2021, në Qarkun Fier;


marrjen e një informacioni zyrtar në cilësinë e provës , bazuar në nenin 137, pika 1 të Kodit Zgjedhor, nga Departamenti i Administratës Publike për numrin e punonjësve në institucionet publike, vendore apo qendrore dhe si ka ndryshuar ky numër në Qarkun Fier për periudhën 01 janar 2020 – 01 maj 2021;

marrjen një informacioni zyrtar nga bashkitë e Qarkut Fier, agjencitë e varësisë dhe shoqëritë në pronësi të shtetit apo bashkive, për numrin e punonjësve të institucioneve publike, vendore apo qendrore dhe si ka ndryshuar ky numër për periudhën 01 janar 2020 – 01 maj 2021;

marrjen e një informacioni zyrtar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale dhe bashkitë e qarkut të Fierit, lidhur me numrin e familjeve që kanë përfituar ndihmë ekonomike, dhe ndryshimin e masës ekonomike në periudhën 01 janar 2020 – 01 maj 2021 brenda këtij qarku;

marrjen e një informacioni zyrtar nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, lidhur me fazën e hetimeve, përsa i përket të dhënave qytetare, të dhënave personale;

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

marrjen e një informacioni zyrtar nga INSTAT-i mbi numrin e shqiptarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë, pra konkretisht numri i shqiptarëve që jetojnë në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut me të drejtë vote;

marrjen e një informacioni zyrtar nga Ministria e Shëndetësisë, me numrin e personave të infektuar me Covid 19, në datën 25.04.2021 në Qarkun Fier, në moshë madhore, pra që kishin të drejtën për të votuar;

marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit mbi numrin e shtetasve shqiptarë, që kanë hyrë në Shqipëri në periudhën 19 prill 2021 – 25 prill 2021 nga Republika e Greqisë dhe Maqedonia e Veriut, dhe kjo mund të detajohet dhe më tej në listën e personave, të cilët rezultojnë me vendbanim në Qarkun e Fierit;

marrjen e një informacioni zyrtar nga OSHE, mbi gjitha shpërblimet që u janë dhënë punonjësve të kësaj kompanie shtetërore për Qarkun Fier, në periudhën 01 janar 2020 – 01 maj 2021;

dhe së fundmi siç pata mundësi edhe ta them përpara këtij Komisioni, marrjen e të dhënave të kryqëzuara ndërmjet pajisjeve të identifikimit elektronik PEI për zonën zgjedhore, Qarku i Fierit.

Në vlerësimin tonë, marrja e këtyre provave, pavarësisht se deri tani është refuzuar në mënyrë të përsëritur, në të tetë kërkesat që ne kemi parashtruar deri më tani para këtij Komisioni, zbardh të plota të gjitha pretendimet që Partia Demokratike dhe Aleanca për Ndryshim kanë ngritur para këtij Komisioni. Faleminderit!

Z.I.Rusmali: Faleminderit juve! Reagim nga palët e interesuara për kërkesën, për marrje provash? Partia Socialiste?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Z.M.Legisi, përfaqësues i PS-së: Po, faleminderit i nderuar! Kërkojmë rrëzimin e kërkesës edhe sikur të administrohen këto prova, ato tregojnë për fakte apo ngjarje që nuk kanë ndodhur në qendrën e votimit, sikurse e përcakton dhe Kodi Zgjedhor. Kërkoj rrëzimin e kërkesës! Faleminderit!

Z.I.Rusmali: Faleminderit! Përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim?

Znj.S.Caka, përfaqësuese e LSI-së: Po, mbështesim kërkesën e kolegut të Partisë Demokratike. Faleminderit!

Z.I.Rusmali: Faleminderit juve! Mirë atëherë, KAS-i mbështetur në pikën 3, të nenit 21, vendosi: Rrëzimin e kërkesës me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës për marrjen e këtyre provave!


Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Ndjesë, kush është shumica e votave?

Z.I.Rusmali: Sipas pikës 3, të ta shpjegoj ndryshe. Pika 3 thotë që pranohet kërkesa në qoftë se pro saj, votojnë 3 vetë. Pro saj kanë votuar 2 anëtarë, prandaj rrëzohet kërkesa.

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Pra, është barazim!

Z.I.Rusmali: Rrëzohet kërkesa. Dakord mbaj barazimin, pa problem, por kërkesa nuk pranohet! Nuk pranohet kërkesa sepse kështu thotë pika 3. Tani 2 anëtarë të KAS-it, siç ka ndodhur dhe në rastet e tjera përputhin kompetencën e tyre për të tërhequr prova nga administrata, për të kërkuar prova nga administrata e KQZ-së,

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

kanë vendosur që të kërkojnë të dhëna për kryqëzimin e të dhënave për pajisjet PEI, për Qarkun e Fierit. Kështu që kjo kërkesë i përcillet administratës së KQZ-së që të procedojë sipas ligjit edhe lidhur me të. Nga ana tjetër KAS-i vendosi kryesisht, i kërkoi KQZ-së, që t'i japë informacion lidhur me rezultatin e votimit për Partinë Socialiste, nuk na interesojnë partitë e tjera, në qendrat e votimit të fshatit Buzëmadh, në Cakran, në zgjedhjet e 25 prillit dhe në zgjedhjet e vitit 2017. Gjithashtu, unë kam bërë një tabelë, nga të dhënat publike që kam unë, që siguroj unë në rrugë informale, jo në rrugë zyrtare. Kemi një tabelë këtu për administratën, të dhënat e rezultatit për qendrën e votimit të burgut të Fierit, IEVP-ja Fierit. Ne ju kërkojmë që ta verifikoni përmbajtjen e kësaj tabele dhe të konfirmoni, ose të korrigjoni këtë përmbajtje dhe të na e risillni ne dhe palëve, të saktë dhe zyrtare. Do t'ju jap juve në fund, këto dy kërkesa i kemi ne si KAS, sepse na ndihmojnë në shqyrtimin e pretendimeve të palës. Me këtë mbyllim...

Z.L.Braho: Një pyetje, këto kërkesat, çfarë do me thënë kryesisht dhe kush është KAS-i, se unë tani po i shoh këto, këto dy kërkesat?

Z.I.Rusmali: Jo, këtë, rezultati agregat...

Z.L.Braho: Është me propozim anëtarësh, është me vendimmarrje?

Z.I.Rusmali: Mendova se e konsultuam paraprakisht, por s'ka problem!

Z.L.Braho: Jo, thjesht më dhatë këtë, unë e pashë, e kuptova që ishte e burgut.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Z.I.Rusmali: Edhe e konsultuam, por nuk e ke pasur mendjen, s'ka gjë, nuk prish punë! Atëherë me kërkesën e dy anëtarëve, timen dhe të kolegut, ju lutem plotësojeni këtë!

Z.L.Braho: Po, qëllimi zoti Rusmali?

Z.I.Rusmali: Kjo ka lidhje me provën tuaj nr.41, ndërsa ajo e Buzëmadhit, ka lidhje me, tani duhet ta gjej, me provën që ju, me referimin për ngjarjen e Buzëmadhit, që thoni ju. Ka lidhje me punësimet në mos gaboj. Është informacion që kompletton kontekstin e ngjarjes, duam të shohim më mirë rreth ngjarjes. Në rregull, s'ka gjë tjetër? Atëherë ne këtu duhet të ndërpresim këtë seancë sepse duhet lënë kohë për marrjen dhe shpërndarjen e këtyre provave, palëve dhe anëtarëve të Komisionit. Kjo seancë do të riçelet ditën e hënë, por për orarin do të njoftoheni në kohë të mjaftueshme, në avancë dhe do të vazhdojë pastaj me pjesën e shqyrtimit të provave të mbledhura sipas kërkimeve dhe me pretendimet përfundimtare të palëve.


Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Një gjë për procedurë, i nderuar? Në mënyrë që ditën e hënë në qoftë se caktohet një orar, të mos kërkojmë shtyrjen, po është e mundur administrata të na vërë provat në dispozicion.

Z.I.Rusmali: Në avancë!

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Brenda ditës së nesërme!

Z.I.Rusmali: Brenda ditës së nesërme e bëni ju dot atë kryqëzimin e të dhënave?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Z.Y.Merkaj: Po, besoj po!

Z.I.Rusmali: Në rregull, mundësisht brenda ditës së nesërme t'u vihet në dispozicion palëve! Mirë, e zgjidhëm dhe këtë! Atëherë e ndërpresim këtu seancën për ta rinisur atë ditën e hënë!

Z.L.Braho: Këtë e konsiderojmë dakord, por kemi lënë Qarkun e Lezhës dhe nga administrata, meqenëse është njoftuar ankimuesi, që është kandidati i propozuar nga zgjedhësit, ka ardhur ai? Keni ndonjë informacion? Ose nga komunikimi kishte synimin për të ardhur apo për ta zhvilluar seancën?

Z.Y.Merkaj: Jo, kemi komunikuar, por me çfarë kuptojmë ne, nuk do të vijë në seancë. Nuk do paraqitet.

Z.L.Braho: Ndonjë subjekt i interesuar ka bërë kërkesë për Qarkun e Lezhës?

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Partia Demokratike ka paraqitur një kërkesë.

Z.Y.Merkaj: Po, dhe Partia Socialiste e ka paraqitur kërkesën.

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Parimi është që, duke qenë se pala ankuese duhet të vlerësojmë, që duhet të jetë prezente, domethënë për të dëgjuar.

Z.L.Braho: Pala ankuese ka marrë dijeni, por...

Zbardhi materialin audio

Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.05.2021*

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: E kam të qartë zoti Rusmali. Unë mendoj që për hir të procesit, është mirë që të kemi dhe palën ankuese, ne jemi palë të interesuara. Mund ta mbështesim, mund ta kundërshtojmë, ju do vendosni.

Z.I.Rusmali: Kjo seancë do shtyhet për nesër në orën 11:00, më duket? Atëherë seanca e Lezhës do shtyhet për nesër në orën 11:00, ju mund t'i bëni dhe një njoftim tjetër për dijeni. Në qoftë se kandidati nuk ka dëshirë të vijë, ai është i lirë edhe të mos vijë, s'e detyron njeri. Seanca zhvillohet gjithsesi. Mirë, e mbyllim gjithçka!

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

